




**BALLKANI PERËNDIMOR NË UDHËKRYQ:  
RAPORT PËRFUNDIMTAR**

# **Ballkani Perëndimor në udhëkryq: Rrugët përpara në analizimin e ndikimit të aktorëve të jashtëm**

**Raport Përfundimtar**

---



**Ballkani Perëndimor në udhëkryq: Rugët përpara në analizimin  
e ndikimit të aktorëve të jashtëm  
Raport Përfundimtar**

Autorët: **Ioannis Armakolas, Senada Šelo Šabić, Barbora Chrzová,  
Petr Čermák, Srećko Latal, Tena Prelec, Anastas Vangeli, Ognjan  
Denkovski, Martin Naunov, Stefan Jojić, Stefan Vladislavljev,  
Gentiola Madhi, Maja Bjeloš**

Përkthyes: **Gentiola Madhi**

**Publikuar nga Prague Security Studies Institute (PSSI),  
Prill 2021, Pragë**

Publikimi është shkruar në kuadër të projektit **“Ballkani Perëndimor  
në Udhëkryq: Rugët përpara në analizimin e ndikimit të aktorëve  
të huaj”** i udhëhequr nga Prague Security Studies Institute me  
mbështetjen e National Endowment for Democracy.

© PSSI 2021

Prague Security Studies Institute, Pohořelec 6  
118 00 Pragë 1, Republika Çeke

[www.pssi.cz](http://www.pssi.cz)

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

## Rreth Projektit & Autorët

<b>Rreth Projektit</b>	4
<b>Rreth Prague Security Studies Institute</b>	4
<b>Lista e Autorëve</b>	5

## Hyrje

Barbora Chrzová dhe Petr Čermák

6

## Seksioni i parë: Narrativat e Brendshme për Prezencat e Jashtme

<b>‘Vëllezërit Tanë,’ ‘Shpëtimtarët Tanë’: Rëndësia e Investimit Kinez për Narrativën e Qeverisë Serbe për Rimëkëmbje Ekonomike</b>	10
Tena Prelec	
<b>“Miqësia e çeliktë” - Formëzimi i Perceptimit të Kinës nga Elita Politike Serbe</b>	11
Stefan Vladislavljev	
<b>Ndikimi ideor i Kinës në Ballkanin Perëndimor 2009-2019</b>	12
Anastas Vangeli	

## Seksioni i dytë: Frakturat e Brendshme dhe Përfshirja e Aktorëve të Huaj – Një Rol Aktiv apo Pasiv?

<b>Reforma zgjedhore vendimtare e Bosnjës dhe Hercegovinës shënon ndarje të reja midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm</b>	14
Srećko Latal	
<b>Erdoğan si një Sultan i Admiruar apo si një Instrument në Konkurrencën Politike? Perceptimet e Vendasve për Praninë Turke në Sanxhakun Serb.</b>	16
Stefan Jojić	
<b>A po i konsideron BE miqtë si të mirëqenë? Partizanizëm dhe Mbështetje për Aktorët e Jashtëm në Maqedoninë e Veriut</b>	17
Martin Naunov	
<b>Infodemia, një Zgjedhje e Parakohshme, dhe një Mikëpritje (e Vakët) Perëndimore: Identiteti i Maqedonisë së Veriut në Rrezik në Twitter</b>	18
<b>Studimi I – Instrumentet e dezinformimit</b>	18
<b>Studimi II – Përmbajtja e dezinformimit</b>	19
Ognjan Denkovski	

## Seksioni i tretë: Bashkëpërgjegjësia e Elitave Politike Vendase për Ndikimet e Dëmshme të Ndikimeve të Huaja

<b>Eko-përbindësia &amp; Eko-luftëtarë: Investimet e Kinës në Industrinë e Rëndë të Prodhimit të Serbisë Parë Përmes Lentës Mjedisore</b>	21
Tena Prelec	
<b>Shuma e të Gjitha Frikërave - Mbikëqyrja e Inteligjencës Artificiale Kineze në Serbi</b>	22
Maja Bjeloš	
<b>“Vëllai ynë Erdoğan” – Nga Marrëdhëniet Zyrtare tek ato Personale të Liderëve Politikë të Shqipërisë dhe Kosovës me Presidentin Turk</b>	24
Gentiola Madhi	

## Seksioni i katërt: Sfidat e Pandemisë së COVID-19 për Ndikimet e Huaja

<b>COVID-19 rrit Stekën Gjeopolitike në Ballkan</b>	26
Srećko Latal	
<b>Ballkani Perëndimor: Midis BE-së dhe një Vendi të Vështirë</b>	27
Srećko Latal	
<b>Ligjërimet e Ballkanit Perëndimor dhe Pozicionimi drejt Kinës gjatë Pandemisë COVID-19</b>	28
Anastas Vangeli	

## Analizë Reflektuese dhe Përfundime

<b>Analiza Reflektuese – Kërkesa e Brendshme për Ndikim Jo-Perëndimor në Ballkanin Perëndimor</b>	30
Senada Šelo Šabić	
<b>Konkluzione – Ndikimi i aktorëve të huaj në Ballkanin Perëndimor: Hapjet, Mbylljet dhe Perspektivat nga Brenda-Jashtë</b>	34
Ioannis Armakolas	



## Rreth Projektit

---

**“Ballkani Perëndimor në Udhëkryq: Rrugët përpara në analizimin e ndikimit të aktorëve të huaj”** është projekti vijues që synon të ndërtojë mbi një bazë njohurish të ndërtuara në projektin pararendës “Ballkani Perëndimor në Udhëkryq: Vlerësimi i veprimtarisë së ndikimit të jashtëm jodemokratik”, i cili hartëzoi, analizoi dhe nxori në pah aktivitetet e ndikimit rus, kinez, turk dhe të vendeve të Gjirit në rajon. Projekti inovativ fokusohet tek humlumtimi social i thelluar, me rrënjë shoqërore dhe gazetari investigative. Dizajni i tij reflekton qëllimin për të shkuar përtej humlumtimit ekzistues dhe kornizave analitike konvencionale, duke kombinuar një larmi qasjesh metodologjike.

Rezultatet e projektit konsistojnë në katërbëdhjetë studime analitike, që hulumtojnë në fusha të përzgjedhura dhe

aspekte të angazhimit të aktorëve të jashtëm në rajon, dhe artikuj gazetareskë të mbështetur në gjetjet e tyre. Të gjitha studimet janë botuar gjithashtu si pjesë e një vëllimi përfundimtar të redaktuar, duke përfshirë më tej edhe dy analiza reflektuese. Ky raport përfundimtar është një version i shkurtuar i vëllimit të redaktuar dhe përmban përmbledhjet ekzekutive të studimeve, teksti i plotë i së cilave është i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze.

Kohëzgjatja e projektit: 10/2019 – 04/2021

Koordinatorët e projektit: Barbora Chrzová

([chrzova@pssi.cz](mailto:chrzova@pssi.cz)), Petr Čermák ([cermak@pssi.cz](mailto:cermak@pssi.cz))

i Anja Grabovac ([grabovac@pssi.cz](mailto:grabovac@pssi.cz))

Këshilltar shkencor: Ioannis Armakolas

## Rreth Prague Security Studies Institute

---

**Prague Security Studies Institute (PSSI)** është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare e themeluar në fillim të vitit 2002 për të avancuar ngritjen e një shoqërie të drejtë, të sigurt, demokratike dhe të tregut të lirë në Republikën Çeke dhe në vende të tjera postkomuniste. Misioni i PSSI-së

është të ndërtojë një grup në rritje profesionistësh të politikës të informuar dhe të vëmendshëm për sigurinë, të përkushtuar për zhvillimin e institucioneve dhe të vlerave demokratike në Evropën Qëndrore dhe Juglindore.



## Lista e Autorëve

---

**Ioannis Armakolas**, Studiues i Lartë & Drejtues i Programit për Evropën Juglindore, Fondacioni Helen për Politikën e Jashtme dhe Evropiane (ELIAMEP); Asistent Profesor në Politika të Krahasuara të Evropës Juglindore pranë Departamentit të Studimeve Ballkanike, Sllavike dhe Orientale, Universiteti i Maqedonisë; Përfitues i bursës kërkimore mbi të ardhmet e Evropës, Instituti për Shkencat Humane, Vjenë.

**Maja Bjeloš**, Studiuese pranë Qendrës së Beogradit për Studime të Sigurisë

**Petr Čermák**, Koordinator Projekti pranë Prague Security Studies Institute dhe Studies pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti Charles

**Barbora Chrzová**, Menaxhere Programi pranë Prague Security Studies Institute dhe doktorante pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti Charles

**Ognjan Denkovski**, Lektor Junior pranë Universitetit të Amsterdimit, Departamenti i Shkencës së Komunikimit dhe një Studiues i Asociuar pranë Indeksit Global të Dezinformimit (Global Disinformation Index)

**Stefan Jojić**, Doktorant pranë Fakultetit të Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit

**Srećko Latal**, Redaktor Rajonal pranë Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)

**Gentiola Madhi**, Studiuese dhe Analiste Politike

**Martin Naunov**, Doktorant në Shkenca Politike pranë Universitetit të Karolinës së Veriut - Chapel Hill

**Tena Prelec**, Studiuese pranë Departamentit të Politikës dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (DPIR), Universiteti i Oksfordit

**Senada Šelo Šabić**, Studiuese e Lartë e Asociuar pranë Institutit për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (IRMO)

**Anastas Vangeli**, Profesor Vizitor pranë Shkollës së Ekonomisë dhe Biznesit, Universiteti i Lubjanës

**Stefan Vladislavjev**, Koordinator Programi pranë Fondit të Beogradit për Ekselencë Politike



# Hyrje

## Barbora Chrzová dhe Petr Čermák

Zhvendosjet e ekuilibrit të pushtetit global dhe antagoinizmi në rritje midis Perëndimit dhe të gjithë aktorëve të jashtëm kryesorë në Evropën Juglindore - Rusia, Kina dhe Turqia - kanë sjellë së fundmi vëmendjen tek ndikimet e këtyre aktorëve në rajon. Fokusi, edhe i këtij vëllimi, është vendosur veçanërisht tek gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - Serbia, Bosnjë dhe Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova - të cilat, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike brenda hapësirës gjeopolitike të BE-së, mbeten të izoluar dhe të ekspozuara ndaj interesave konkurrues të aktorëve të jashtëm. Me perspektiva anëtarësimi në BE ende të largëta ose të pasigurta dhe angazhimin e luhatur të SHBA-ve, angazhimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën Euro-Atlantike, i cili merrej si i mirëqënë një dekadë më parë, nuk është më i pakontestueshëm.

Rajoni ka qenë tradicionalisht një zonë rivaliteti mes fuqive të mëdha. Pritja e pafundme për integrim në strukturat Euro-Atlantike krijon kështu hapësirë për Rusinë, Kinën ose Turqinë që të forcojnë rrënjët e tyre duke përdorur mjete të ndryshme, përfshirë lidhjet fetare, kulturore dhe politike tradicionalisht të mirëndërtuara, si dhe zgjerimin ekonomik. Për Rusinë dhe Turqinë, Ballkani ka qenë një rajon me interes tradicional. Rusia ka shfrytëzuar kohët e fundit dominimin e saj në sektorin e energjisë dhe popullaritetin mes popullatës sllave të krishterë ortodokse, në veçanti serbe, dhe potencialin armiqësor që buron prej tij. Turqia ka ndjekur një politikë të jashtme ambicioze, duke u mbështetur në zhvillimin e lidhjeve të ngushta personale midis Presidentit turk Recep Tayyip Erdoğan dhe udhëheqësve të Ballkanit dhe në ndihmën e ofruar ndaj komuniteteve lokale myslimane. Në të kundërt, Kina është relativisht një e porsaardhur në Ballkan, por angazhimi i saj ekonomik dhe politik ka qenë në rritje të vazhdueshme dhe ka ngritur kohët e fundit shqetësime të konsiderueshme midis politikëbërësve perëndimorë.

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor sfidohen ende nga tensione dypalëshe të brendshme dhe të ndërsjellta, kriza politike të tejzgjatura, regres demokratik ose vështirësi ekonomike, të cilat e bëjnë stabilitetin e rajonit të brishtë. Meqenëse tensionet rajonale dhe ato globale ushqejnë njëri-tjetrin dhe aktorët jo-Perëndimorë janë në gjendje të shfrytëzojnë me shkathtësi dobësitë lokale, shumë prej veprimtarive ruse, kineze ose turke ngrenë shqetësime

mbi potencialin e tyre për të minuar stabilitetin dhe perspektivat e integritetit Euro-Atlantik të rajonit. Debati midis gazetarëve, studiuesve dhe politikëbërësve Perëndimorë dhe atyre lokalë në lidhje me angazhimin e Rusisë, Kinës ose Turqisë dominohet nga narrativa të cilat e paraqesin ndikimin e tyre si natyrshëm malinj dhe e konsiderojnë konkurrencën e tyre ndaj Perëndimit si një lojë me shumë zero.

Projekti "Ballkani Perëndimor në Udhëkryq" synon të kapërcejë këtë pamje të thjeshtëzuar dhe të shkojë përtej studimeve ekzistuese mbi përfshirjen e aktorëve jo-Perëndimorë në rajon. Ndërsa faza e parë e projektit hartëzoi dhe vlerësoi ndikimin e huaj tek secili shtet i Ballkanit Perëndimor, në një seri punimesh të shkurtra dhe në një botim përfundimtar, faza e dytë, rezultatet e së cilës paraqiten në këtë vëllim, zgjeron bazën e njohurive tashmë ekzistuese në një mënyrë që të udhëheqë drejt një analize të thellë të prezencave jo-Perëndimore në rajon. Në vend të vlerësimit të përgjithshëm të levave të huaja në secilin vend apo fushë, vëllimi përbëhet nga raste studimore që hetojnë mekanizma specifike të ndikimit ose aspekte të ndryshme që lidhen me prezencën e jashtme.

Studimet nuk konvergojnë rreth një pike të vetme, pasi ato janë shumë të ndryshme në metodologji, tema, qëllime, si dhe në stilin e tyre. Ndërsa secili prej rasteve studimore merret me një temë specifike dhe të përcaktuar qartë, të gjitha ato komunikojnë gjithashtu me debatin e përgjithshëm dhe situatën aktuale të njohurive të disponueshme të hulumtimit mbi ndikimet e jashtme në Ballkanin Perëndimor, dhe secili prej tyre paraqet pikëvështrime inovative dhe argumente të reja në lidhje me aspekte të ndryshme të ndikimit rus, kinez apo turk në rajon. Së bashku, gjetjet e paraqitura në këtë vëllim ofrojnë kështu një kontribut multidisiplinor origjinal në debatin aktual shkencor dhe politik, rëndësia e së cilit vijon përtej vet rajonit.

Vëllimi përmban katërmbëdhjetë studime analitike të shkruara brenda kornizës së projektit "Ballkani Perëndimor në Udhëkryq" nga nëntë studiues të rinj dhe senior nga vet rajoni me formime shkencore multidisiplinare dhe përvojë pune, duke përfshirë gazetarë, akademikë dhe analistë nga think-tanke. Projekti u menaxhua nga stafi i Institutit të Studimeve të Sigurisë të Pragës, Barbora Chrzová, Petr Čermák dhe Anja Grabovac, të cilët punuan ngushtë me studiuesit gjatë gjithë procesit të hartimit



të studimeve. Cilësia e punimeve u shqyrta më pas nga Ioannis Armakolas, i cili u angazhua në cilësinë e këshilltarit shkencor të projektit. Vëllimi përfshin gjithashtu reflektime të shkruara mbi studimet nga dy studiues senior, Ioannis Armakolas dhe Senada Šelo Šabić, të cilët reflektojnë mbi pyetjet kryesore në lidhje me temën – kërkesa e brendshme për prezencë të aktorëve të jashtëm dhe çështja e dëmit të shkaktuar nga influenca e huaj.

Publikimi është strukturuar në katër seksione, përgjatë temave më të gjera, të identifikuara si të rëndësishme por të pahulumtuara në kuadër të pasqyrës së përgjithshme, dhe shumica e tyre vendosin vëmendjen tek dimensionin i brendshëm i prezencave të huaja. Secili prej studimeve të paraqitura në secilin seksion kontribuon tek tema e caktuar dhe e shtjellon atë, megjithëse me qasje dhe fokusime shumë të ndryshme metodologjike. Sidoqoftë, grupimi i studimeve nën këto katër tema më të gjera nuk ka qenë një detyrë e lehtë, pasi ka mbivendosje të konsiderueshme dhe disa studime flasin për më shumë se një prej tyre.

Seksioni i parë shqyrton narrativat e brendshme për prezencat e jashtme. Më konkretisht, të tre punimet adresojnë mënyrën sipas së cilës elitat lokale ose media portretizojnë dhe flasin për angazhimin kinez. Studimet e Tena Prelec dhe Stefan Vladisavljev shqyrtojnë narrativat pozitive rreth Kinës dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë të promovuar nga elita serbe në pushtet. Punimi i Prelec tregon se si Presidenti serb Aleksandër Vuçiç dhe partia e tij SNS përdorin narrativën e shpëtimit ekonomik nga miqtë e huaj, aktualisht të përfaqësuar nga Kina, për të konsoliduar pushtetin e tyre. Vladisavljev hartëzon figurat politike përgjegjëse për shpërndarjen e këtyre narrativave në mënyrë që të fitojnë pikë politike dhe tregon se ekziston një konsensus i habitshëm midis elitave politike për qëndrimin pozitiv ndaj Kinës. Punimi nga Anastas Vangeli e ka fokusin në nivel rajoni dhe eksploron ndikimin ideor të Kinës në Ballkanin Perëndimor. Ai argumenton se Kina ka qenë më pak e suksesshme në promovimin e imazhit të saj pozitiv dhe në sigurimin e objektivave të saj në krahasim me çka tenton të supozohet sepse në nivel ligjërimit mbizotëron dominimi Perëndimor.

Seksioni i dytë adreson çështjen e roleve të aktorëve të jashtëm në lidhje me frakturat e brendshme. Ndërsa punimi i Srećko Latal analizon pozicionet dhe aspiratat e aktorëve të huaj në debatin rreth reformës së pritshme zgjedhore në Bosnjë dhe Hercegovinë, studimet e tjera tregojnë se aktorët e jashtëm shpesh luajnë një rol pasiv më shumë se sa aktiv. Analiza e Stefan Jojić mbi praninë turke,

e bazuar në pothuajse njëqind intervista me elita dhe qytetarë të zakonshëm në Sanxhak, demonstron se si elitat lokale përdorin referencat ndaj Turqisë dhe presidentin të saj Erdoğan në mënyrë që të forcojnë pozicionet e tyre në përplasjet për pushtet. Punimet e Martin Naunov dhe Ognjan Denkovski trajtojnë rastin e Maqedonisë së Veriut dhe demonstron se si konkurrenca e brendshme politike është e lidhur ngushtë me debatin mbi orientimin gjeopolitik të vendit, pavarësisht faktit se të gjitha partitë e mëdha zyrtarisht mbështesin integrimin Euro-Atlantik. Punimi i Naunov tregon se partizanizmi është një faktor i rëndësishëm në mbështetjen popullore të aktorëve të jashtëm dhe pohon se ndarja midis orientimit pro-Perëndimor dhe pro-Lindor të mbështetësve (përkatesisht) të LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së i atribuohet orientimeve të partisë. Të dy studimet nga Denkovski trajtojnë të njëjtën konkurrencë partiake dhe analizojnë shfaqjen e metodave kompjuterike të propagandës në Twitter-in maqedonas në periudhën para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020. Analiza e tij e një databaze origjinale të përbërë nga mijëra tweets, përdoret dhe ndërveprime tregon se metodat e dezinformimit kompjuterik u përdorën për të formëzuar diskutimet publike në periudhën parazgjedhore dhe identifikon një rrjet përdoruesish të krijuar në prag të zgjedhjeve që ndante përmbajtje në kundërshtim me integrimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE.

Seksioni i tretë gjithashtu vendos dimensionin e brendshëm në fokus dhe shqyrton përgjegjësinë e elitave të brendshme politike për ndikimet malinje të angazhimeve të huaja. Duke përdorur raste studimore, secili prej të tre autorëve përqendrohet në çështje specifike socio-politike ku elita e brendshme po shfrytëzon përfshirjen e aktorëve të jashtëm për arritjen e qëllimeve të veta politike. Tena Prelec, në një studim të bazuar në punën e saj në terren mes OJQ-ve mjedisore lokale, heton përgjegjësinë e autoriteteve serbe dhe investitorëve kinezë për dëmet mjedisore të dukshme në zonat ku kompanitë kineze kanë investuar në industrinë e rëndë. Maja Bjeloš merret me çështjen e teknologjive të mbikëqyrjes kineze që po futen në Serbi. Të dyja argumentojnë se elita politike serbe në pushtet duhet të mbajë përgjegjësi për efektet malinje të angazhimit kinez, pasi po përdor teknologjinë dhe kapitalin kinez për arritjen e qëllimeve të veta, pavarësisht pasojave të tyre negative tek mjedisi apo tek demokracia dhe liritë. Gentiola Madhi gjithashtu diskuton në punimin e saj mbi rolin aktiv të elitave lokale në instaurimin e partneriteteve me aktorë jo-Perëndimorë, duke u përqendruar tek 'miqësia personale' e promovuar publikisht midis liderëve politikë të Shqipërisë dhe Kosovës dhe presidentit turk Erdoğan. Analiza e saj e



shfaqjeve specifike të këtyre lidhjeve personale tregon se imazhi i miqësisë nuk ka një bazë strukturore dhe është udhëhequr më tepër nga konsiderata pragmatike.

Seksioni i katërt ndryshon në fokusin e tij, pasi përfshin tre studime rreth pasojave të krizës së COVID-19 tek prezenca e aktorëve të jashtëm. Aktualiteti i zhvendosjeve që lidhen me COVID-19 në skenën gjeopolitike globale dhe përkthimi i tyre në hapësirën e Ballkanit Perëndimor na kanë shtyrë që t'i vëmë në dukje këto punime. Në dy punimet e tij, Srećko Latal heton ndryshimet dinamike në gjeopolitikën e rajonit gjatë periudhës së dominuar nga kriza e COVID-19 në nivel vendor, rajonal dhe global. Punimi i tij i parë hartëzon se si situata pandemike interferoi me zhvillimet e tjera gjeopolitike afatgjata dhe se si ky ndërveprim ndikoi në pozicionet e fuqive të mëdha të jashtme në rajon. Në studimin e tij të dytë, Latal i dedikohet posaçërisht ndikimit të krizës së COVID-19 tek politika evropiane ndaj Ballkanit Perëndimor dhe argumenton se përshkallëzimi i luftës gjeopolitike për ndikim në rajonin edhe një herë konfirmoi rëndësinë e angazhimit të BE-së në stabilizimin e fqinjësisë së saj. Anastas Vangeli ndjek panoramën e Latal në analizën e tij mbi ndikimin politik të krizës COVID-19 tek ligjërimet mbi Kinën në rajon. Ai ofron një kategorizim gjithëpërfshirës të përgjigjeve të dhëna nga elitat rajonale ndaj rolit të Kinës, të cilat ndryshonin në kohë, si dhe sipas shteteve të veçanta. Në përgjithësi, të dy këta autorë tregojnë qartë se situata pandemike jo vetëm që u përshpejtua, por gjithashtu ndryshoi

në mënyrë të konsiderueshme luftën e vazhdueshme gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor.

Kjo përmbledhje e shkurtër e studimeve, dhe temave më të gjera që ato trajtojnë, bën me dije se edhe pse fokusi kryesor i këtij projekti është vendosur tek ndikimi i aktorëve të jashtëm jo-Perëndimorë, debati rreth tij nuk mund të vijojë pa një vlerësim të aspekteve të brendshme mbi prezencat e huaja dhe të rolit të aktorëve Perëndimorë. Hulumtimi mbi ndikimin e aktorëve jo-Perëndimorë në këtë rajon, i cili aspiron t'i bashkohet strukturave Euro-Atlantike, nuk mund të jetë kurrë i plotë pa një vlerësim kritik të rolit dhe përgjegjësisë të SHBA-së, të NATO-s dhe të BE-së si dhe të shteteve të saj anëtare. Ballkani Perëndimor po bëhet sërisht një pikë e rëndësishme gjeopolitike ku ndikimet e jashtme nga Lindja dhe Perëndimi takohen me fraktura të brendshme të thella. Gjetjet themelore të këtij vëllimi tregojnë se roli i aktorëve të jashtëm nuk mund të hetohet dhe kuptohet i veçuar nga kërkesa e brendshme për ndikimin e tyre. Ana e brendshme e kërkesës paraqitet si një pjesë thelbësore e enigmës për të kuptuar rreziqet që lidhen me aktivitetet ruse, turke ose kineze. Sikurse ilustron shumica e studimeve të paraqitura në këtë vëllim, shpesh janë në fakt elitat e brendshme që i mundësojnë hapësirë ose madje kontribuojnë për ndikimet malinje të prezencave të jashtme. Ndaj, kontributi më i madh i këtij vëllimi qëndron në hedhjen e më shumë drite mbi mekanizmat e këtyre proceseve dhe motivimet e secilit prej aktorëve të përfshirë.





## **Seksioni i parë: Narrativat e Brendshme për Prezencat e Jashtme**

---



# ‘Vëllezërit Tanë’, ‘Shpëtimtarët Tanë’: Rëndësia e Investimit Kinez për Narrativën e Qeverisë Serbe për Rimëkëmbje Ekonomike

Tena Prelec

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Studimi analizon se si partia në pushtet në Serbi ka përdorur bashkëpunimin ekonomik në rritje të vendit me fuqitë jo-Perëndimore për të promovuar një narrativë ‘fituese’. Autorja sjell njohuri të reja se si lidhshiptari serb ka përdorur temën e rilindjes ekonomike në lidhje me një narrativë që përshkruan shpëtimin ekonomik nga miqtë e huaj, të cilët vijnë në ndihmë për të çuar përpara fuqinë e saj politike. Tregohet se ky rol, i luajtur fillimisht nga Emiratet e Bashkuara Arabe, është ndërmarrë nga Kina që nga mesi i viteve 2010.

Si është përdorur bashkëpunimi ekonomik në rritje i Serbisë me aktorët jo-Perëndimorë për të çuar përpara një narrativë ‘fituese’ nga Partia Progresive Serbe (SNS) gjatë konsolidimit të pushtetit të tyre (2012-2020)? Dhe si ka funksionuar kjo në rastin e aktorit – pra Kinës - që ka rritur fuqimisht lidhjet e saj ekonomike me Serbinë në fund të viteve 2010? Këto janë dy pyetjet kryesore të adresuara në këtë studim. Ndërsa rëndësia e narrativës ekonomike për partitë politike të Aleksandër Vuçiçit është vendosur në literaturë, një vlerësim sesi ka ndryshuar me kalimin e kohës mungon. Mandej, deri më tani nuk ka pasur ndonjë përpjekje domethënëse për të vënë temën e ‘rilindjes ekonomike’ në lidhje me marrëdhëniet e Serbisë me aktorët e jashtëm; ky është një hendek i rëndësishëm në literaturë, duke marrë parasysh se përfitimet e asistencës ekonomike nga jashtë janë theksuar në mënyrë të përsëritur nga lidhshiptari serb.

Prandaj, ky studim ndjek mënyrën se si Partia Progresive Serbe (SNS) ka përdorur temën e asistencës ekonomike nga jashtë për të ndërtuar dhe konsoliduar dominimin e saj në skenën politike serbe nga viti 2012 deri në 2020. Argumentohet se, nën udhëheqjen e Aleksandër Vuçiçit,

shteti serb ka ndjekur një strategji të ‘uljes në disa stola’. Ndërsa strategjia e ‘dy stolave’ që i përshkruhet Vuçiçit zakonisht konceptohet si një zgjedhje me dy kahe midis Perëndimit dhe Lindjes, këtu pohohet se partia në pushtet e Serbisë (SNS) ka ndjekur një narrativë që shkon përtej këtij dualizmi, duke zgjedhur, në të kundër, për pasjen e një spektri më të gjerë aleatësh tek të cilët mund të mbështetet. Aftësia për të tërhequr fonde nga disa vende, mundësia për t’a paraqitur këtë si një sukses me audiencat vendase dhe ndërkombëtare, si dhe kërcënimi i nënkuptuar ndaj BE-së (‘nëse nuk na bëni për vete sa duhet, ne kemi partnerë të tjerë ku të mbështetemi’), kanë qenë tiparet kryesore të sundimit të Vuçiçit.

Përmes analizës së mbulimit të mediave vendase dhe ndërkombëtare, argumentohet se ndërtimi i një narrative të rilindjes ekonomike ka ecur paralelisht me një narrativë që përshkruan shpëtimin ekonomik në formën e miqve të huaj që vijnë në ndihmë. Tregohet se si ky rol, fillimisht i luajtur nga Emiratet e Bashkuara Arabe, u ndërmorë më vonë nga Kina. Argumentohet se kanali i kësaj veprimtarie të asistencës “së huaj” është në fakt vetë lidhshiptari politik serb (në pozicionin e presidentit aktual serb Aleksandër Vuçiç), i cili kërkon të paraqitet si i aftë për t’i ofruar popullatës stabilitet dhe siguri, duke ruajtur kështu ‘sigurinë ontologjike’ të kombit serb. Gjetjet e studimit ofrojnë njohuri se pse politika e jashtme serbe ka qenë, në dukje, kaq e paqëndrueshme gjatë viteve të fundit: nga pikëpamja narrative, lidhshiptari serb ka zgjedhur aktorin që ishte më i dobishëm për vënien në dukje të veprimtarisë së tyre për shpëtimin e kombit në çdo moment të caktuar.

# “Miqësia e çeliktë” – Formëzimi i Perceptimit të Kinës nga Elita Politike Serbe

**Stefan Vladislavljev**

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Elita politike serbe ka arritur t’a perceptojë Kinën si një partner të besueshëm dhe të dobishëm, dhe po e portretizon atë si të tillë për publikun e gjerë serb, duke gjeneruar një imazh pozitiv të vendit midis popullit serb. Serbia ka qenë gjithashtu një partner i rëndësishëm për Kinën në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe politikanët serbë e kanë përqaftuar këtë marrëdhënie dhe e kanë mbështetur atë përmes një sërë mekanizmash. Kjo marrëdhënie miqësore përshkruhet shpesh nga anëtarët e elitës politike serbe si një “miqësi e çeliktë” midis dy vendeve. Partneriteti midis Serbisë dhe Kinës është intensifikuar që nga viti 2009, me nënshkrimin e një marrëveshje strategjike për bashkëpunim ekonomik, teknologjik dhe infrastrukturor midis dy vendeve dhe ka arritur nivelin e partneritetit strategjik që prej asaj kohe.

Prania kineze në Serbi, shpesh e ekzagjeruar, e ka ndihmuar koalicionin qeverisës aktual të udhëhequr nga presidenti Aleksandër Vuçiç dhe Partinë e tij Progresive Serbe (SNS) për të konsoliduar pushtetin politik. Gjatë dekadës së fundit, centralizimi i pushtetit politik dhe kontrolli

i mekanizmave qeverisës i kanë hapur rrugën elitës politike në Serbi që të popullarizojë bashkëpunimin politik dhe ekonomik me Kinën, t’a ngrejë atë në nivelin e partneritetit strategjik dhe t’a paraqesë si të tillë për publikun serb. Nga ana tjetër e spektrit politik, liderët aktualë të opozitës ishin paraardhësit e Vuçiçit në zhvillimin e marrëdhënieve me Kinën dhe e paraqisnin atë si një “shtyllë të politikës së jashtme” dhe partner të ngushtë të Serbisë. Kjo ka krijuar një mungesë kritike nga udhëheqësit e opozitës kur bëhet fjalë për rritjen e nivelit të bashkëpunimit midis Beogradit dhe Pekinit.

Ky studim identifikon se cilët janë aktorët politikë kryesorë serbë që promovojnë lidhje më të ngushta me Pekinin, si dhe nëpërmjet cila mënyrave dhe mekanizmave e përdorin ata Kinën për të fituar pikë në politikën e brendshme. Argumentohet se angazhimi për partneritetin kino-serb do të mbetet konstant në qasjen e elitës politike serbe, pavarësisht nga partia politike dhe politikanët në pushtet.

# Ndikimi ideor i Kinës në Ballkanin Perëndimor 2009–2019

---

**Anastas Vangeli**

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Si një aktor global me një trajektore të veçantë të shënuar nga ngritja e saj ekonomike dhe qasja proaktive pas krizës financiare globale, Kina tashmë ka një ndikim të rëndësishëm ideor në mënyrën se si elitat në rajone të ndryshme mendojnë jo vetëm për ekonominë politike globale, por gjithashtu rolin e tyre në të. Ky është gjithashtu rasti i Ballkanit Perëndimor, i cili ka vërejtur ndërveprim të shtuar me Kinën jo vetëm duke qenë pjesë e 'Nismës Brezi dhe Rrugës' dhe e platformës së Kinës për bashkëpunim me Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore të quajtur "17+1". Sidoqoftë, shpesh, ndërlikimet që karakterizojnë procesin e ndikimit ideor neglizhohen nga studiuesit dhe politikëbërësit.

Ky studim synon të zbërthejë format e ndryshme të ndikimit ideor të Kinës. Ai propozon dy kritere që ndihmojnë në dallimin midis tyre: roli i synimeve të Kinës (disa forma të ndikimit janë të qëllimshme ndërsa të tjerat jo), dhe shkalla e ndërmjetësimit (disa forma të ndikimit ndodhin si rezultat i ndërveprimit të drejtpërdrejtë, të pandërmjetësuar, ndërsa të tjerat ndërmjetësohen). Një kornizë e tillë vlen gjithashtu edhe për agjencinë e aktorëve rajonalë, si dhe për ndikimet e aktorëve të tjerë të jashtëm (në radhë të parë, BE-ja dhe SHBA-ja).

Punimi tregon se në periudhën 2009-2019 Kina ka arritur të ndikojë në mënyrën se si elitat e Ballkanit Perëndimor mendojnë për Kinën, por jo në nivelin që synonin fillimisht aktorët kinezë. Ndërsa aktorët nga rajoni e kanë mirëpritur idenë e prosperitetit rajonal nën kornizën e 'Brezi dhe Rrugës', ata nuk dëshirojnë transformime më të gjera globale. Gjithashtu, në kundërshtim me përpjekjen e Pekinit për të mos u përfshirë në debate të brendshme politike, Kina është shndërruar një temë gjithnjë e më e politizuar për shkak të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Më e rëndësishmja, si rezultat i tensioneve midis SHBA-së dhe Kinës, aktorët e Ballkanit Perëndimor gjithnjë e më shumë tani i bashkëngjiten (dhe nganjëherë e instrumentalizojnë) vizionit primacist me shumë zero të politikës globale. Një kontradiktë kryesore që po formëson qëndrimin e aktorëve të Ballkanit Perëndimor është besimi (ose më mirë dëshira) që bashkëpunimi ekonomik kino-ballkanik në rritje mund të arrihet i izoluar nga çfarëdolloj shqetësimi të rëndësishëm në status quo-në gjeopolitike. Duke iu referuar shkurtimisht dinamikës që ka sjellë pandemia COVID-19, punimi arrin në përfundimin se inputet e jashtme do të mbeten variabli kryesor që formëson të menduarit për Kinën midis elitave të Ballkanit Perëndimor.



## **Seksioni i dytë: Frakturat e Brendshme dhe Përfshirja e Aktorëve të Huaj – Një Rol Aktiv apo Pasiv?**

---



# Reforma zgjedhore vendimtare e Bosnjës dhe Hercegovinës shënon ndarje të reja midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm

**Srećko Latal**

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Thellimi i krizës politike në Bosnjë dhe Hercegovinë, shtrirja e së cilës u zbulua gjatë pandemisë së COVID-19 dhe gjatë zgjedhjeve lokale të 2020, ka ringjallur interesin e publikut për reformën zgjedhore të vendit. Pas shmangies dhe vonesës së reformave të sistemit të elektoral të ndjerë për vite me radhë, liderët e Bosnjës dhe Hercegovinës janë tani të detyruar të merren me këtë çështje në mes të krizave shumëdimensionale shëndetësore, politike dhe ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

Reforma e sistemit zgjedhor të Bosnjës dhe Hercegovinës është një nga sfidat më të mëdha të vendit që nga Marrëveshja e Dejtonit pasi ngre pyetje kritike në lidhje me marrëdhëniet midis tre popujve të saj përbërës dhe vetë natyrën e sistemit politik të Bosnjës dhe Hercegovinës. Rëndësia dhe kompleksiteti i debatit mbi reformën tërheq gjithashtu vëmendjen rajonale dhe ndërkombëtare, veçanërisht nga Kroacia dhe Serbia fqinje ose BE-ja, SHBA-ja dhe Rusia. Pozicionet e aktorëve kryesorë lokalë mbi reformën zgjedhore të mundshme variojnë gjerësisht dhe marrin drejtime të ndryshme, shpesh të kundërta.

Ky punim analizon pozicionet dhe strategjitë e ndryshme të aktorëve kryesorë mbi reformën e mundshme zgjedhore të sistemit elektoral të ndjerë dhe të korruptuar të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe përshkruan kontekstin lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Ai përqendrohet kryesisht tek aktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët janë të përfshirë në negociata. Duke pasur parasysh situatën e ngërçit pothuajse të plotë politik, si dhe mosbesimin midis liderëve lokalë, rezultati i kësaj reforme ka të ngjarë të përcaktohet nga ndikimet e jashtme.

Analiza tregon se pozicionet e ndryshme pasqyrojnë pikëpamje të ndryshme që partitë boshnjake, kroato-boshnjake dhe serbe kanë mbi të kaluarën, të tashmen dhe

të ardhmen e Bosnjës dhe Hercegovinës. Nëse është e suksesshme, reforma jo vetëm që do të sistemonte sistemin zgjedhor të vendit, por gjithashtu do të rishikonte Marrëveshjen e Uashingtonit dhe marrëdhëniet midis liderëve boshnjakë dhe kroato-boshnjakë, çka është kritike për mbijetesën e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Më tej punimi argumenton se duke pasur parasysh thellësinë e bllokimit politik lokal, rezultati i kësaj reforme do të përfundojë edhe një herë në varësi të angazhimit të SHBA-së dhe BE-së, si dhe ndikimeve të tjera të huaja. Vëmendja e ripërtërirë që Uashingtoni dhe kryeqytetet e BE-së po i kushtojnë kohët e fundit Ballkanit duket inkurajuese. Sidoqoftë, nëse Perëndimi dëshiron të arrijë një zgjidhje në Bosnjë dhe Hercegovinë pas 15 vitesh përpjekje të dështuara të reformës, ai do t'i duhet të vendosë të veprojë më në fund dhe të gjejë një qasje tjetër për të adresuar problemet e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Çdo përpjekje e Perëndimit do të përballlet me kundërshtim jo vetëm nga aktorët lokalë por edhe nga aktorët e tjerë rajonalë dhe ndërkombëtarë. Një nga rolet kryesore në shpалosjen e reformës zgjedhore të Bosnjës dhe Hercegovinës do të luhet nga Kroacia, e cila tashmë ka shfaqur të gjithë muskulin e saj politik dhe diplomatik pas lidhshimit kroato-boshnjak dhe është e vendosur të sigurojë që në të ardhmen zyrtarët kroato-boshnjakë të zgjidhen nga ata që ata i konsiderojnë si votuesit "legjitimë" të kroato-boshnjakëve. Në përpjekjet e saj, Kroacia mund të gjejë aleatë të pamundur në Serbi dhe Rusi, pasi Zagrebi, Beogradi dhe Moska duan t'a mbajnë sistemin politik të Bosnjës dhe Hercegovinës shumë të decentralizuar dhe të bazuar në etni.



Reforma e ardhshme është e kapur pas një ngërçi ligjor dhe politik. Nga njëra anë, gjashtë vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut i kërkojnë ligjvënësëve të Bosnjës dhe Hercegovinës që të eliminojnë diskriminimin etnik nga Kushtetuta e saj. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës, në vendimin e saj të 2016, u bën thirrje atyre të ndryshojnë ligjin zgjedhor për të siguruar që përfaqësuesit politikë të një populli përbërës të mos zgjidhen nga grupe të tjera etnike.

Gjetja e një ekuilibri të duhur midis këtyre dy poleve pothuajse të kundërta, si dhe midis zgjidhjeve të ndryshme etnike, politike dhe teknike për reformën zgjedhore të Bosnjës dhe Hercegovinës brenda një mjedisi kaq të vështirë dhe një afati kohor të kufizuar do të jetë jashtëzakonisht e vështirë. Megjithatë, dështimi nuk duhet të jetë një alternativë, pasi do të rrezikonte fatin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me prokurë stabilitetin e Ballkanit dhe të gjithë Evropës.



# Erdoğan si një Sultan i Admiruar apo si një Instrument në Konkurrencën Politike? Perceptimet e Vendasve për Pranimë Turke në Sanxhakun Serb.

Stefan Jojić

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim kërkon të plotësojë boshllëkun mbi hulumtimin e politikës turke në Ballkan, duke ofruar njohuri origjinale mbi prezencën e Turqisë në rajonin Sanxhakut të Serbisë, me një fokus të veçantë tek perceptimet lokale. Më konkretisht, ky studim fokusohet tek perceptimi i vendasve ndaj pranisë turke, si dhe ndryshimet në perceptim midis grupeve të ndryshme etnike, politike, ideologjike dhe atyre të interesit. Artikulli trajton gjithashtu mënyrën se si faktori i huaj po përdoret në konfrontimet politike midis grupeve të ndryshme me interes politik në Sanxhak. Duke pasur parasysh tiparet e tij historike, demografike dhe gjeopolitike, si dhe rëndësinë e deklaruar për strategjet në Ankara, rajoni i Sanxhakut është një terren i frytshëm për të eksploruar politikën e jashtme të Turqisë në rajon.

Punimi mbështetet në burimet primare dhe sekondare, si dhe në të dhëna të përfutuara nga dhjetra intervista me elitat dhe qytetarët e qyteteve dhe qytezave të Sanxhakut. Rezultatet konfirmojnë divergjencën e supozuar midis perceptimeve të qytetarëve etnikë serbë dhe elitave politike dhe të homologëve të tyre boshnjakë. Ndërsa të parët kanë kryesisht qëndrime negative rreth prezencës turke, të cilët e vëzhgojnë atë përmes lenteve të një agjende realpolitike pak a shumë transparente, grupi i dytë karakterizohet nga qëndrime pozitive në lidhje me prezencën e Turqisë.

Sidoqoftë, elitat boshnjake nuk janë homogjene në perceptimin e tyre dhe jo të gjithë e shohin prezencën turke vetëm në terma pozitivë. Ndryshe nga kundërshtarët e tyre nga partitë e tjera boshnjake, anëtarët e Partisë Konservatore për Drejtësi dhe Pajtim dhe elitat liberale mund të veçohen se kanë pikëpamje disi më pragmatike dhe kritike ndaj Turqinë. Prandaj ky rast sinjalizon një divergjencë të qartë të qëndrimeve ndaj Turqisë midis poleve të ndryshme politike dhe ideologjike të popullatës boshnjake.

Rezultatet gjithashtu tregojnë se reputacioni i Turqisë midis boshnjakëve të Sanxhakut është instrumentalizuar nga grupet lokale të interesit politik në përplasjet e tyre të ndërsjella. Me synimin për të minuar pozicionet e rivalëve në Turqi apo për të ndikuar tek opinioni publik lokal, disa aktorë lokalë përpiqen të paraqesin të tjerët si armiq të Turqisë, ndërsa promovojnë narrativa rreth lidhjeve të tyre të ngushta me Ankaranë. Punimi ofron njohuri origjinale rreth angazhimit të Turqisë në rajon dhe përbën interes për studiuesit e realiteteve socio-politike në Sanxhak dhe në Ballkan, si dhe për ata që janë të interesuar për prezencën e Turqisë në Sanxhak, në Ballkan dhe në Evropë në përgjithësi.





# A po i konsideron BE miqtë si të mirëqenë? Partizanizëm dhe Mbështetje për Aktorët e Jashtëm në Maqedoninë e Veriut

Martin Naunov

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Rezultatet e agreguara të sondazheve shpesh kanë bërë që analistët të supozojnë se debati “Lindje kundër Perëndimit” në Maqedoninë e Veriut nuk është një çështje polarizuese dhe se qytetarët maqedonas janë në maxhorancë të etur për të parë vendin e tyre të përfshirë në strukturat institucionale Euro-Atlantike. Në këtë punim, unë analizoj një sërë sondazhesh – përfshirë sondazhet e IRI, NDI dhe USAID – dhe tregoj se ndërsa virtualisht të gjithë shqiptarët etnikë janë në favor të anëtarësimit në BE dhe NATO, maqedonasit etnikë janë, në fakt, gjerësisht të ndarë për çështje që lidhen me të ardhmen gjeopolitike të vendit. Unë demostroj se partizanizmi është një nxitës kryesor, ose të paktën faktor parashikues, i kësaj ndarjeje – ata në favor të Partisë Lidhja Social-Demokratike në pushtet (LSDM) janë kryesisht pro-Perëndimor në orientimin e tyre, ndërsa mbështetësit e partisë së dytë më të madhe, partia e djathtë populiste VMRO-DPMNE, shfaqin anshmëri ndaj Rusisë. Unë argumentoj se kjo ndarje së paku pjesërisht i atribuohet orientimeve të elitave partiake, pavarësisht pretendimit të të gjitha partive kryesore (përfshirë VMRO-DPMNE) se janë pro-Perëndimore.

Në një përpjekje për të ilustruar më mirë retorikën e elitave të partisë dhe qëndrimin në debatin “Lindje kundër Perëndimit” dhe për të filluar ilustrimin e rëndësisë së orientimeve të elitës, unë përqëndrohem tek dy nga rastet më të rëndësishme në historinë e afërt të integritimit Euro-Atlantik të Maqedonisë së Veriut: skandali i përgjimeve i 2015 dhe referendumi për ndryshimin e emrit i 2018. Shkurtimisht,

unë argumentoj se retorika e elitave të partisë në lidhje me BE-në, NATO-n dhe Rusinë gjatë këtyre ngjarjeve fillon të hedhë poshtë strategjinë e liderëve të VMRO-DPMNE-së për të shtirur besnikëri ndaj komunitetit Euro-Atlantik - duke i lejuar kështu atyre të korrin përfitimet ekonomike që lidhjet me BE-në mundësojnë - ndërkohë që njëkohësisht e bëjnë për vete Rusinë dhe rrëzojnë parimet kryesore Euro-Atlantike në lidhje me të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë. Unë demostroj se strategjia e VMRO-DPMNE-së për të “luajtur në të dy kahet” nuk i është shmangur votuesve, të cilët në pjesën më të madhe kanë deshifruar me sukses orientimet e elitave të partisë dhe janë bërë të shumë të vetëdijshëm për ndryshimin midis LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së përsa i përket angazhimit të mirëfilltë për të përmirësuar perspektivat e integritimit të vendit në BE dhe NATO. Si i tillë, në përgjigje të kësaj retorike, unë shpjegoj se si mbështetja midis votuesve të VMRO-DPMNE-së e integritimit në BE dhe NATO ka rënë ndjeshëm.

Si përfundim, ky punim paralajmëron se komplikime të tjera të padrejta në lidhje me negociatat e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE mund të minojë besimin e qytetarëve maqedonas në kredibilitetin e angazhimit të BE-së ndaj vendit. Nga ana tjetër, kjo jo vetëm që do të zvogëlonte fuqinë e BE-së për të nxitur demokratizimin, por gjithashtu mund të gërryey mbështetjen për integritimin Euro-Atlantik, i cili, siç unë demostroj, është tashmë më i pasigurt se sa supozohet shpesh.



# Infodemia, një Zgjedhje e Parakohshme, dhe një Mikëpritje (e Vakët) Perëndimore: Identiteti i Maqedonisë së Veriut në Rrezik në Twitter

Ognjan Denkovski

## Studimi I – Instrumentet e dezinformimit

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

### Përmbledhje Ekzekutive

Studimi shqyrton praninë e metodave kompjuterike të propagandës (së huaj) për qëllime dezinformimi në Maqedoninë e Veriut, një vend pa dalje në det në Gadishullin Ballkanik, një nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor e përfshirë në ligjërimin e lidhur me anëtarësimin në BE. Studimi përqendohet në periudhën rreth zgjedhjeve 2020, fillimisht të planifikuara për në prill 2020, por të shtyra për në korrik 2020 për shkak të pandemisë COVID-19. Ne bazohemi në njohuri të fushatës së parë të propagandës kompjuterike të Maqedoninë e Veriut, përkatësisht fushata #bojkotiram ('Unë bojkotoj') në Twitter, e cila formësoi në mënyrë të konsiderueshme diskutimet rreth referendumit të 2018 për ndryshimin e emrit. Ne aplikojmë disa teknika të identifikimit të botnet, përfshirë kërkimin për modele emërtimi të përsëritura, numra të mëdhenj llogarish të ngjashme të krijuara para ngjarjeve kryesore dhe shkallën e aktiviteteve, të cilët tejkalojnë sjelljen normale të njeriut, të arritura zakonisht nëpërmjet retweet-it. Duke përdorur këto qasje, ne identifikojmë një rrjet të madh përdoruesish të krijuar në prag të zgjedhjeve dhe simpatizues të VMRO-DPMNE-së, parti e djathtë e Maqedonisë së Veriut, sikurse për Levica, një parti e ekstremit të majtë që kundërshton integrimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE. Shumë nga llogaritë e identifikuara kundërshtojnë ndryshimin e emrit të Maqedonisë së Veriut, ndërsa promovojnë gjithashtu përmbajtje konspirative dhe qëndrime anti-Perëndimore. Në të kundërt, shumë pak nga llogaritë e identifikuara shprehin mbështetje për LSDM-në (parti e qendrës së majtë e Maqedonisë së Veriut e orientuar

drejt Perëndimit), për ndryshimin e emrit ose për progresin në procesin e integritimit Euro-Atlantik të vendit. Këto gjetje nuk përputhen me rezultatet e sondazheve të opinionit publik në lidhje me politikën e jashtme të Maqedonisë së Veriut, të cilat tregojnë se shumica e qytetarëve janë në favor të integritimit Euro-Atlantik. Për më tepër, ne zbulojmë se rrjeti i identifikuar ka mbivendosje dhe ndërveprim të gjerë me llogaritë e krijuara fillimisht për fushatën #bojkotiram, e cila është akoma aktive në Twitter.

Analiza sugjeron që rrjeti i identifikuar në këtë studim ka të ngjarë të drejtohet nga aktorë vendas, pasi ne nuk identifikuam ndonjë përfshirje të huaj direkte. Gjithsesi, edhe nëse asnjë aktor i huaj nuk ka kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e rrjetit të identifikuar, gjetjet tregojnë se kushtet për akses të lehtë të aktorëve të interesuar në zhvillimin e fushatave dezinformuese në vend janë të pranishme, si në drejtim të njohurive teknike ashtu edhe në atë të rrjeteve ekzistuese të llogarive (të automatizuara), të cilat promovojnë ndjenjat anti-Perëndimore. Studiuesit e fokusuar në identifikimin dhe reagimin ndaj fushatave dezinformuese në mediat sociale në Ballkanin Perëndimor këshillohen të marrin në konsideratë karakteristikat e emërtimit dhe datat e krijimit të llogarive - të cilat lidhen ngushtë - të identifikuara në këtë studim, duke i kushtuar vëmendje të veçantë temave dhe çështjeve që u përkasin votuesve dhe partive të djathta në rajon, të tilla si ato të mbështetura nga VMRO-DPMNE e Maqedonisë së Veriut apo nga SNS serbe.



## Studimi II – Përmbajtja e dezinformimit

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

### Përmbledhje Ekzekutive

Fushatat e dezinformimit shpesh e bazojnë veprimtarinë e tyre tek postimet në mediat sociale ose tek deklaratat e liderëve politikë, mesazhet e të cilëve amplifikohen ose përdoren për të lehtësuar sulmet politike ndaj kundërshtarëve. Ky ishte gjithashtu rasti për rrjetin e identifikuar në Studimin I të këtij projekti kërkimor - një rrjet i zhvilluar me qëllim zgjedhjet e vitit 2020 në Maqedoninë e Veriut, i cili e përqendroi veprimtarinë e tij në amplifikimin e postimeve të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) e qendrës së djathtë dhe të Levica [‘E Majta’], ndërsa gjithashtu denigronte zyrtarët e Partisë Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë (LSDM) e qendrës së majtë. Sidoqoftë, jo të gjitha fushatat e dezinformimit mbështeten në aktivitetin e rrjeteve të organizuara të kontrolluara nga qendra. Përkundrazi, shumë fushata dezinformimi janë rezultat i përmbajtjes së botuar dhe të shpërndarë nga media me agjenda të dyshimta, pronësi të paqarta dhe mungesë të politikave editoriale transparente. Kjo përmbajtje më pas shpërndahet midis grupeve organike të përdoruesve të mediave sociale të ndjeshme ndaj pikëpamjeve të promovuara nga këto media.

Ky studim paraqet pjesën e dytë të një projekti kërkimor që analizon praninë e dezinformimit kompjuterik të huaj në Maqedoninë e Veriut në periudhën rreth zgjedhjeve të 2020. Periudha elektorale dhe studimi ndodhen midis disa zhvillimeve të rëndësishme në politikën e jashtme të Maqedonisë së Veriut, përfshirë anëtarësimin në NATO dhe fillimin e pritshëm të negociatave të anëtarësimin në BE - zhvillime që sfidojnë qëllimet e aktorëve të huaj që kundërshtojnë integrimin Euro-Atlantik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos Rusia. Për të kryer analizën, ne mbledhëm rregullisht 100 tweet-et më popullore të grumbulluara nga portali i lajmeve më i vizituar i Maqedonisë së Veriut Time.mk. Këto tweet-e u mbledhën çdo dy orë çdo ditë midis fillimit të shkurtit dhe fillimit të gushtit të 2020 - gjithsej 138,983 tweet-e unike u shpërndanë nga 5,604 përdorues unikë. Ne i përdorëm këto të dhëna për të

përcaktuar faqet e internetit më të shpërndara (specifikisht nga mediat) në këtë periudhë, si dhe për të përcaktuar se cilët hashtagë nxitën diskutime rreth zgjedhjeve. Ne gjithashtu i lidhim gjetjet tona me rezultatet e Studimit I të këtij projekti kërkimor, ku identifikua një rrjet të gjerë llogarish të krijuara në prag të zgjedhjeve të 2020 me qëllim rritjen e vizibilitetit së zyrtarëve të VMRO-DPMNE-së dhe të Levica, kryesisht si një mjet për të amplifikuar përmbajtjen në kundërshtim me integrimin Euro-Atlantik të vendit, duke denigruar gjithashtu zyrtarët e LSDM-së. Së pari, ne tregojmë se postimet nga llogaritë e liderit të VMRO-DPMNE-së Hristijan Mickoski, si dhe ato të liderit të Levica Dimitar Apasiev, shpesh ishin në krye të postimeve ditore në këtë periudhë, pavarësisht numrin relativisht të ulët të ndjekësve në Twitter. Kjo gjetje sugjeron se rrjeti i identifikuar në Studimin I të këtij projekti kërkimor ishte efektiv në promovimin e tweet-eve të këtyre aktorëve midis komuniteteve organike të Twitter-it në Maqedoninë e Veriut.

Gjithashtu, ne demonstruam se media Infomax, një media me të paktën lidhje indirekte me lajmet e financuara nga shteti rus, si dhe media Freeglobe, DokazMakedonija dhe Kolozeg, të cilat të gjitha mbështesin VMRO-DPMNE-në dhe promovojnë pikëpamje konspirative të bazuara në përmbajtje të djathta globale dhe të brendshme, formësuara diskutimet e përdoruesve të Twitter-it në Maqedoninë e Veriut në këtë periudhë. Së fundmi, ne demonstruam se hashtagët politikisht përmbajtësorë më të njohur në këtë periudhë promovojnë kundërshtinë ndaj ndryshimit të emrit të Maqedonisë së Veriut si dhe ndaj integritit Euro-Atlantik të vendit. Ndërsa studimi nuk identifikoi ndikim të drejtpërdrejtë të huaj, gjetjet tregojnë se metodat kompjuterike të dizinformimit u përdorën për të formësuara diskutimet publike kryesisht me përmbajtje të përafuar me qëllimet gjeo-politike të aktorëve të huaj që kundërshtojnë përparimin e vendit në rrugën e tij të integritit Euro-Atlantik.



## **Seksioni i tretë: Bashkëpërgjegjësia e Elitave Politike Vendase për Ndikimet e Dëmshme të Ndikimeve të Huaja**

---



# Eko-përbindësha & Eko-luftëtarë: Investimet e Kinës në Industrinë e Rëndë të Prodhimit të Serbisë Parë Përmes Lentes Mjedisore

Tena Prelec

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Në gjysmën e dytë të viteve 2010, Kina u bë një nga investitorët kryesorë në Serbi. Disa nga investimet e saj më të mëdha, të lidhura me industrinë e rëndë, janë shoqëruar me një rritje të dukshme të niveleve të ndotjes, duke shkaktuar shqetësime të mëdha midis popullsisë lokale dhe duke shndërruar shumë qytetarë në aktivistë mjedisorë. A është rreziku për shëndetin i vërtetë apo i perceptuar, dhe kush është fajtori? Duke përdorur intervistat me aktivistë dhe ekspertë, si dhe dokumentet zyrtare dhe përgjigjet e qeverisë, punimi analizon mënyrat se si janë të ndërlidhura shqetësimet mjedisore, çështjet e qeverisjes dhe një qeveri e 'kyçur'. Në kontrast me mitin e Kinës si një "investitor i keq", argumentohet se përgjegjësia kryesore qëndron tek institucionet e vendit përfitues, që lejojnë të ndodhin abuzime të tilla mjedisore.

Punimi analizon dy raste studimore kryesore: uzina e shkrirjes së bakrit e ndodhur në Bor (e administruar nga Zijin Mining e Kinës në 2018) dhe fabrika e çelikut në Smederevo (e blerë nga Hesteel Group në 2016). Aktivizmi civil spontan është shfaqur si përgjigje ndaj rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore në të dy rastet. Perceptimi i gjetjes se vetvetes midis dy zjarreve - një investitor që kërkon të maksimizojë interesat e tij dhe një qeveri që lejon të vuajë shëndeti i qytetarëve në këmbim të përfitimit ekonomik - ka shkaktuar zemërim të gjerë mes popullatës. Kjo ndihmon për të shpjeguar se pse aktivizmi mjedisor i është

bashkuar ndjenjave antiqeveritare: zërat e aktivistëve nuk janë as neutralë, dhe as nuk mund të jenë, pasi të dy janë të ndërlidhur. Rastet e shqyrtuara ilustrojnë kështu çështjet e lidhura me investimet kineze, por gjithashtu edhe mënyra specifike të rezistencës ndaj konceptimit dominant të pushtetit në Serbi.

Problemet që karakterizojnë rastet studimore të paraqitura në këtë punim reflektohen në të tjera investime kineze në Serbi (të tilla si centrali i qymyrit në Kostolac dhe një fabrikë gomash në Zrenjanin), dhe përtej Serbisë gjithashtu (p.sh. në Bosnjën dhe Hercegovinën fqinje, zgjerimi i një termocentrali qymyri shumë ndotës në Tuzla i financuar nga kinezët). Ndaj, ato nuk janë raste të izoluar. Hartimi i shumicës së këtyre marrëveshjeve si 'Projekte me Interes Kombëtar' i vendos investitorët mbi ligjet që të tjerët duhet të respektojnë dhe i lejon autoritetet të refuzojnë shumicën e kërkesave për të Drejtën e Informimit. Argumentohet se përzjerja specifike e shqetësimeve mjedisore dhe qeverisëse e shpaktuar në këtë studim duhet të jetë shumë më në krye dhe në qendër të politikës së kushtëzimit të BE-së dhe ndihmës së bazuar në vlerat demokratike sesa është për momentin. Për më tepër, këto çështje duhet të shihen në kuadër të një morie praktikash klienteliste dhe kleptokratike që të dy, BE-ja dhe administrata e re e Biden në SHBA, janë zotuar të luftojnë.



# Shuma e të Gjitha Frikërave – Mbikëqyrja e Inteligjencës Artificiale Kineze në Serbi

Maja Bjeloš

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria serbe, në bashkëpunim me kompaninë kineze të teknologjisë Huawei, ka punuar në mënyrë aktive në zbatimin e projektit të mbikëqyrjes “Qytet i Sigurt” në Beograd që nga viti 2019. Projekti përfshin instalimin e mijëra kamerave të mbikëqyrjes inteligjente me aftësi identifikimi objektesh dhe tipareve të fytyrës. Ky punim synon të hedhë më shumë dritë mbi diskutimet e vazhdueshme në lidhje me përdorimin e teknologjisë kineze nga autoritetet serbe. Ai ofron informacion në lidhje me kontekstin politik në Serbi dhe thellimin e marrëdhënieve të saj me Kinën në sektorin e sigurisë. Ai paraqet narrativën zyrtare të qeverisë mbi përfitimet e sistemit të mbikëqyrjes inteligjente të zhvilluar nga Huawei, i cili mbështetet në aftësinë e tij të pretenduar për të luftuar terrorizmin dhe për të ulur shkallën e krimit. Punimi më pas vazhdon me shqyrtimin e argumentave kryesorë kundër përdorimit të kamerave të hartuar nga aktorët e shoqërisë civile serbe. Ai analizon se si shoqëria civile sfidon përdorimin e teknologjisë kineze dhe cilat janë përgjigje kritike ndaj përdorimit të saj përgjatë tre linjave kryesore: mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, rreziku i keqpërdorimit të kamerave të mbikëqyrjes inteligjente për qëllime politike dhe rregullimi i dobët ligjor.

Kjo analizë tregon se projekti i mbikëqyrjes inteligjente biometrike ka ngritur shqetësime në lidhje me përkeqësimin e privatësisë, si dhe të drejtave dhe lirive të njeriut në Serbi. Publiku serb nuk ndan të njëjtat shqetësime me aktivistët sepse i mungon informacioni bazë mbi qëllimin e të gjithë projektit. Qeveria serbe e ka klasifikuar projektin e mbikëqyrjes si “konfidencial” dhe shmang debatin publik mbi përfitimet dhe rreziqet e tij të mundshme. Ka ende shumë pyetje pa përgjigje, të tilla si: ku do të ruhen të dhënat, kush do të jetë përgjegjës për përpunimin e të dhënave dhe cilat janë mekanizmat për mbrojtjen nga keqpërdorimi, ku janë instaluar kamerat, sa të tilla ekzistojnë dhe cili është funksioni i tyre. Kontrolli i fortë i informacionit dhe hapësirës mediatike nga qeveria serbe e bën të vështirë dëgjimin e zërave kritikë. Ndërgjegjësimi

i publikut në lidhje me termat e paqartë të projektit “Qytet i Sigurt” është gjithashtu i kufizuar nga mungesa e mbikëqyrjes së fortë parlamentare dhe rregullimi i dobët i teknologjisë artificiale, çka krijon hapësirë për manovra politike dhe dominim të ekzekutivit mbi ligjin.

Kamerat e mbikëqyrjes të pajisura me programe softëtare për identifikimin e fytyrës janë veçanërisht shqetësuese për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktivistët qytetarë (civik) në Serbi sepse ky sistem do të përdoret në një vend me demokraci të dobët, abuzim të pushtetit ekzekutiv dhe sistem të dobët të kontrolleve dhe ekuilibrave. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë pra frikë se teknologjia e përparuar e Kinës do të forcojë kapacitetet e lidhshme gjithnjë e më autoritar të Serbisë për të kontrolluar çdo qytetar dhe të gjitha aspektet e jetës, dhe kështu të rrezikojë më tej demokracinë e saj të dobët dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, aktivistët civil kanë frikë se kamerat e njohjes së fytyrës do t'i lejojnë autoritetet serbe të ndjekin dhe të trembin kritikët e elitës politike në pushtet.

Rregullimi i dobët ligjor i mbikëqyrjes video në Serbi dhe mungesa e ligjeve që rregullojnë sistemin e identifikimit të fytyrës dhe përpunimin e të dhënave biometrike paraqesin një tjetër linjë argumentimi kundër aplikimit të mbikëqyrjes inteligjente. Sipas zërave kritikë në shoqërinë serbe, nëse kjo teknologji e fuqishme e identifikimit të fytyrës nuk rregullohet dhe trajtohet ligjërisht nga profesionistët të trajnuar nën kontrollin demokratik civil, sistemi i mbikëqyrjes mund të keqpërdoret lehtësisht. Mungesa e rregullimit ligjor është një nga arsyt kryesore pse shoqëria civile serbe u ka bërë thirrje autoriteteve kombëtare të pezullojnë procesin e aplikimit të mbikëqyrjes inteligjente dhe të përfshihen në një debat publik gjithëpërfshirës mbi domosdoshmërinë dhe implikimet e një sistemi të tillë.

Punimi tregon gjithashtu se kërkesat e përfaqësuesve të shoqërisë civile për të adresuar mangësitë ekzistuese, për



të siguruar një bazë ligjore për përdorimin e sistemit të mbikëqyrjes inteligjente, si dhe për të kryer vlerësime të mëtejshme mbi të gjitha rreziqet e ndërlidhura mbeten pa përgjigje nga autoritetet serbe. Ministria e Brendshme vazhdoi të instalojë kamera të mbikëqyrjes inteligjente në Beograd gjatë shpërthimit të coronavirus-it pa ndonjë njoftim ose informacion publik të disponueshëm, si dhe ka njoftuar për mbikëqyrje edhe më të madhe në të ardhmen e afërt, pasi qyteti i Beogradit do të mbulohet tashmë me 8,100 kamera në vend të 1,000 kamerave fillestare.



# “Vëllai ynë Erdoğan” – Nga Marrëdhëniet Zyrtare tek ato Personale të Liderëve Politikë të Shqipërisë dhe Kosovës me Presidentin Turk

**Gentiola Madhi**

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim përqendrohet në forcimin e marrëdhënieve personale midis liderëve të Shqipërisë dhe Kosovës me Presidentin turk dhe ekzistencën e tyre paralele me marrëdhëniet tradicionale ndërshtetërore. Në veçanti, punimi merret me qasjen e Presidentit Erdoğan për zhvendosje nga marrëdhëniet institucionale ndërshtetërore drejt mbizotërimit dhe favorizimit të marrëdhënieve personale kokë më kokë me udhëheqësit e shteteve, si një mënyrë alternative për të tejkaluar kufirin ndarës mes çështjeve të brendshme dhe të jashtme. Një zhvendosje e tillë në rastet e Shqipërisë dhe Kosovës vlerësohet e rrezikshme, me një ndikim negativ në perspektivat e tyre të demokratizimit dhe në nxitjen e praktikave ad hoc në procedurat administrative shtetërore.

Punimi analizon dy lidhje miqësore midis liderëve në bazë të tre dimensioneve, përkatësisht: (i) shfaqja e miqësisë personale në fushën publike; (ii) axhenda fetare e Turqisë jashtë vendit; dhe, (iii) kërkesat ekstraterritoriale të Turqisë kundër mbështetësve të lëvizjes Gylen. Dimensioi i parë reflektohet tek përpjekjet e liderëve për të ‘idealizuar’ marrëdhëniet e tyre dhe për të përcjellë tek opinioni publik imazhin e ‘miqësisë’ përmes mediave, ndërsa dy dimensionet e tjera janë të lidhura në mënyrë rigorozë me dy përparësitë kryesore të agjendës turke në Ballkan. Ambivalenca e fuqisë së butë fetare të Turqisë dhe përpjekja e saj për të eksportuar konfliktin e saj të brendshëm në Shqipëri dhe Kosovë

vlerësohen thelbësore për të kuptuar shkallën në të cilën ky personalizim i marrëdhënieve është i një natyre strategjike dhe transaksionare.

Hulumtimi mbështetet në trekëndëzim i burimeve në mënyrë që të adresojë limitet që rrjedhin nga natyra personale dhe subjektive e marrëdhënies midis liderëve, mungesa e burimeve të larmishme të informacionit, si dhe mungesa e përgjithshme e transparencës dhe llogaridhënies gjatë spostimit të liderëve nga takimet zyrtare tek ato informale kokë më kokë, duke injoruar kështu procedurat zyrtare që gjurmojnë procesin vendimmarrës.

Rezultatet tregojnë se lidhjet miqësore janë promovuar në bazë të një kongruence të përkohshme të interesave politike dhe përfitimeve të llogaritura, duke mos patur kështu një bazë strukturore për institucionalizim të marrëdhënies në nivelin shtetëror. Në rastin e Shqipërisë, Kryeministri Rama ka ndjekur një qasje ambivalente karshi agjendës së Turqisë dhe koncesionet e tij ndaj kërkesave turke janë shpërblyer siç duhet. Ndërsa në rastin e Kosovës, miqësia e Thaçit me Erdoğanin ka rezultuar më pak e ekuilibruar përse i përket fuqizimit të ndërsjellë. Plotësimi i kërkesave turke ka rezultuar në një shfrytëzim të dobësive të brendshme të Kosovës në favor të agjendës ‘gërryese’ turke.





## **Seksioni i katërt: Sfidat e Pandemisë së COVID-19 për Ndikimet e Huaja**

---



# COVID-19 rrit Stekën Gjeopolitike në Ballkan

**Sreçko Latal**

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Ballkani, sikurse pjesa tjetër e botës, u trondit dhe u përkul nga shpërthimi i krizës së COVID-19 në fillim të këtij viti. Megjithatë, kjo rezultoi të ishte vetëm qetësia përpara stuhisë, pasi tensionet etnike, fetare, politike, të sigurisë, ekonomike dhe sociale u rritën në të gjithë rajonit që prej muajit prill. Ky përshkallëzim lidhej kryesisht me grindjet politike të shkaktuara nga fakti se shumica e vendeve të Ballkanit kishin planifikuar zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme apo lokale gjatë vitit 2020.

Pandemia e coronavirus-it ka intensifikuar garën, që zgjat prej vitesh, të aktorëve kryesorë globalë për pushtet dhe ndikim në rajon. Kina, BE-ja, vendet e Gjirit, Rusia, SHBA-ja dhe Turqia, të gjitha nxituan për të ndihmuar vendet e Ballkanit, por gjithashtu u përpoqën që të përdorin këtë mundësi për të forcuar pozicionet e tyre në këtë rajon në lojërat e tyre të vazhdueshme gjeopolitike. Ndërsa Kina dhe vendet e Gjirit u përqëndruan kryesisht tek çështjet humanitare dhe ekonomike, skenën kryesore e zunë qëndrimet agresive të rinovuara të Rusisë dhe Turqisë në rajon, si dhe përpjekja e Shtetësisë së Bardhë për të ndërmjetësuar një marrëveshje rrufe mes Kosovës dhe Serbisë.

Ndërsa një seri demonstratash të dhunshme tronditën Serbinë dhe Malin e Zi në muajt e fundit, zyrtarët e tyre dhe media u ankuan për atë çka ata thanë se ishte përfshirja e drejtpërdrejtë ruse në organizimin e protestave. Zyrtarët rusë mohuan këto akuza, por disa ekspertë paralajmëruan se Rusia vërtet po përpjetet të përdorë të gjitha burimet e saj në Ballkan për të ndaluar apo edhe për të përmbysur zgjerimin e NATO-s dhe BE-së në rajon. Disa fajësuan Rusinë për përpjekjen për të parandaluar një marrëveshje Kosovë-Serbi në mënyrë që të mund të ruaj ndikimin e saj në Ballkan. Të tjerë thanë se ambiciet "pan-sllave" ruse ishin përqëndruar tek përdorimi i problemeve dhe ndasive të brendshme të BE-së dhe SHBA-së për të bashkuar të gjitha kombet sllave nën komandën ruse.

Roli turk në Ballkan është eklipsuar muajt e fundit nga sjellja gjithnjë e më agresive e Ankarasë në Mesdhe dhe në Lindjen e Mesme, përfshirë luftrat në Siri dhe Libi.

Megjithatë, gjetjet e fundit tregojnë se shtetasit turq të lidhur me regjimin e Erdoğanit kanë krijuar një terren për rrjetet kriminale dhe/ose paraushtarake në Ballkan që nga fillimi i 2020, çka ngre pikëpyetje në lidhje me angazhimin dhe planet e Ankarasë për rajonin.

Kriza e COVID-19 vërejti gjithashtu një zhvendosje të mëtejshme të politikës së SHBA-së ndaj rajonit, duke vazhduar një trend i cili u bë për herë të parë i dukshëm me zgjedhjet e fundit presidenciale në SHBA në 2016. Ndërsa në një rën anë SHBA-ja ofroi ndihmë financiare të konsiderueshme dhe transparente për të gjitha vendet e Ballkanit, nga ana tjetër kjo u la në hije dhe u njollos nga përpjekja e Shtetësisë së Bardhë për të firmosur një marrëveshje rrufe midis Kosovës dhe Serbisë. Presioni i fortë i të dërguarit special të SHBA-së për bisedimet Serbi-Kosovë, Richard Grenell, minoi aftësinë e qeverisë kosovare për të përballuar pandeminë dhe si përfundim çoi në rrëzimin e kryeministrit kosovar Albin Kurti.

Kjo seri zhvillimesh vazhdoi pothuajse çdo ditë, duke kërcënuar shtyrjen e Ballkanit përtej skajit të destabilizimit të mëtejshëm dhe ndoshta drejt konflikteve të reja etnike ose shoqërore. Megjithëse këto dinamika parandalojnë çdo analizë të besueshme afatgjate, shumica e ekspertëve pajtohen se në këtë situatë vetëm BE-ja ka aftësinë për të stabilizuar gradualisht dhe për të normalizuar Ballkanin.

Nëse BE-ja do të ketë sukses tani në atë çka nuk arritur të bëjë gjatë 15 viteve të fundit, do të merret vesh këtë vjeshtë, kur BE-ja pritet të gjenerojë të shumëpriturin "Plan Marshall" për rajonin. Ky plan do të skicojë një seri reformash dhe kushtesh të tjera përmes së cilave vendet e Ballkanit do të jenë në gjendje të përdorin një kombinim grantesh dhe huash me vlerë 3.3 miliardë euro që BE-ja i ndau për Ballkanin në prill. Gjithsesi BE-ja do të duhet të procedojë me shumë kujdes dhe mençuri nëse dëshiron t'a shfrytëzojë mirë këtë mundësi; përndryshe grindjet lokale, rajonale dhe gjeopolitike në Ballkan ka gjasa të vazhdojnë të përshkallëzohen, me pasojë potencialisht shkatërruese.



# Ballkani Perëndimor: Midis BE-së dhe një Vendi të Vështirë

Srećko Latal

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Që prej fillimit të 2020, pandemia e COVID-19 ka krijuar një kontekst për një përshkallëzim të ri të tensioneve rajonale dhe të konkurrencës gjeopolitike në Ballkan. Ndërsa muajt e fundit panë falimentimin e “diplomacisë së maskave” kineze, e “vëllazërisë historike” ruso-serbe dhe ndërprerjen e nismës së paqes Serbi-Kosovë të Shtëpisë së Bardhë, Bashkimi Europian u rishfaq si aleati kryesor i rajonit dhe si e vetmja forcë stabilizuese e vërtetë. Sidoqoftë, siç tregon dhe dokumenti i politikave, pavarësisht aftësisë së tij të gjerë financiare dhe perspektivës së zgjerimit, BE-ja është ende larg prej të pasurit të pozicionit të tij të sigurt në rajon.

Nga njëra anë, tensionet rajonale dhe gjeopolitike në rritje ende ofrojnë mundësi të shumta për kriza të reja ballkanike në muajt e ardhshëm. Nga ana tjetër, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor nuk shihen sy më sy për një sërë çështjesh në lidhje me procesin e zgjerimit, i cili ka qënë themeli i marrëdhënies së tyre. Pikëpamjet dhe interesat e tyre divergjente kanë shkaktuar vitet e fundit shumë keqkuptime dhe në disa raste mosbesim midis BE-së dhe vendeve ballkanike.

Pozicioni i BE-së në rajon është tashmë vënë në provë nga mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit midis nismave të udhëhequra nga BE-ja dhe nga SHBA-ja mbi dialogun Beograd-Prishtinë, i cili vazhdon në fillim të shtatorit me takime të veçura të planifikuara në Shtëpinë e Bardhë dhe

në Bruksel. Kjo përçarje brenda dhe midis BE-së dhe SHBA-së sjell probleme të reja jo vetëm për vet dialogun, por për të gjithë Ballkanin, pasi dobëson më tej ndikimin e BE-së dhe SHBA-së dhe krijon hapësirë të re për interesat kinez, rusë, turq apo të tjerë.

Nëse BE-ja dëshiron të forcojë pozicionin e saj në rajon dhe të ndihmojë në stabilizimin dhe normalizimin e tij gradual, do të duhet të ndryshojë thelbësisht perceptimin dhe qasjen e saj ndaj Ballkanit Perëndimor – diçka që vet Brukseli dhe vendet anëtare të BE-së kanë shmangur me ngulm gjatë dekadës së kaluar. Një veprim i tillë mund të jetë në kundërshtim me mençurinë konvencionale politike të BE-së, veçanërisht pasi vëmendja e saj është aktualisht e përqëndruar në sfida shumë më urgjente dhe kritike – nga kriza e brendshme shëndetsore dhe ekonomike e lidhur me COVID-19 tek situata në Bjellorusi dhe marrëdhëniet e brishta me SHBA-në, Kinën dhe Rusinë. Megjithatë, të gjithë aktorët e tjerë globalë tashmë po përfshijnë Ballkanin Perëndimor në lojërat e tyre gjeopolitike. Do të ishte praktike për BE-në të bënte të njëjtën gjë, të konsideronte Ballkanin Perëndimor jo vetëm një përgjegjësi, por edhe një aset – në të cilën mund, për mirë apo për keq, të influencojë stabilitetin e kontinentit, siç ka bërë herë pas here në të shkuarën.

# Ligjërimit e Ballkanit Perëndimor dhe Pozicionimi drejt Kinës gjatë Pandemisë COVID-19

Anastas Vangeli

Për të lexuar studimin e plotë në anglisht, vizitoni faqen e internetit të [WBC](#) ose [PSSI](#).

## Përmbledhje Ekzekutive

Pandemia COVID-19 e ka vendosur Kinën në qendër të vëmendjes në lajmet globale, duke intensifikuar diskutimin tashmë vibrant për ngritjen e saj në mbarë botën - dhe në Ballkanin Perëndimor gjithashtu. Për vendet e Ballkanit Perëndimor, Kina ka qenë përgjithësisht larg shqetësimit kryesor pasi COVID-19 përfshiu rajonin. Sidoqoftë, ndër-lidhja e COVID-19 me shpërthimin në Provincën e Hubeit ishte shumë e fortë për të mos e marrë parasysh Kinën. Më vonë, vetë Kina ishte proaktive dhe me kalimin e kohës e pozicionoi veten si një aktor i jashtëm i rëndësishëm në rajon gjatë pandemisë, ndërsa tërhoqi vëmendjen e vëzhguesve të shqetësuar në Perëndim, të cilët gjithashtu kanë pasur një ndikim në mënyrën se si aktorët rajonalë e kanë parë dhe e kanë pozicionuar vetveten në lidhje me Kinën.

Ligjërimit mbi Kinën në Ballkanin Perëndimor gjatë pandemisë COVID-19 vijuan në tre faza. Në fazën e hershme (përafërsisht janar - mars 2020), tema kryesore ishte mbi nisjen e shpërthimit të pandemisë në Kinë; më vonë, ndërsa shpërthimi në Kinë u luhat dhe shpërthimet dominuan diku tjetër (afërsisht prill - shtator 2020), përfshirë Ballkanin Perëndimor, debatet u përqëndruan në të ashtuquajturën “diplomaci e maskave” dhe tek konkurrenca gjeopolitike në lidhje me përgjigjen ndaj pandemisë; dhe së fundmi, debati hyri në fazën e “diplomacisë së vaksinave” pasi vaksinat kundër COVID-19 u bënë një tjetër subjekt i konkurrencës gjeopolitike, me efekte të përvetësuar

gjithashtu në Ballkanin Perëndimor (që nga tetori i 2020 dhe duke u përshkallëzuar në fillim të 2021). Fillimisht, Kina u pa përmes prizmit të kaosit në Ëuhan dhe skepticizmit global për trajtimin nga ana e saj të krizës; në fazën e “diplomacisë së maskave” ajo u pa si një aktor i jashtëm që mund të ishte një burim ndihme ose burim telashesh (ose i të dyjave); dhe në fazën e “diplomacisë së vaksinave” ajo është parë si një partner në përpjekjet për të imunizuar popullsinë e rajonit kundër COVID-19. Qëndrimet e aktorëve rajonalë nuk kanë qenë të njëtrajtshme. Qasja e Serbisë për kërkim aktiv të mundësive ka spikatur, në krahasim me qasjen nën radar të qeverive të tjera, të cilat u alternuan midis oportunitizmit dhe kujdesit. Ka pasur alarmistë vigjilentë për rolin e Kinës edhe në rajon gjithashtu, por jo midis elitave në pushtet.

Zhvillimet gjatë pandemisë COVID-19 ripohuan se si një marrëdhënie tepër asimetrike, raporti Ballkan Perëndimor-Kinë varet fuqimisht nga pozicioni dhe veprimet e Pekinit në skenën botërore. Aktualisht Kina është i vetmi aktor i jashtëm në Ballkanin Perëndimor që nuk po përballet me pasiguri të thellë në frontin e brendshëm dhe ka luksin të planifikojë të ardhmen në frontin e jashtëm. Në disa mënyra, ky është një shembull i përsëritjes së historisë, pasi ajo çka lehtësoi ardhjen e Kinës si një aktor në rajon në dekadën e fundit ishte pikërisht shfaqja e saj në formë më të mirë përballë Perëndimit pas krizës financiare globale.



# **Analizë Reflektuese dhe Përfundime**

---



# Analiza Reflektuese – Kërkesa e Brendshme për Ndikim Jo-Perëndimor në Ballkanin Perëndimor

**Senada Šelo Šabić**

Tema e ndikimit të jashtëm në Ballkanin Perëndimor (BP) është një fushë në zhvillim e politikës dhe e interesit shkencor. Një supozim i përbashkët është se prania në rënie e BE-së dhe SHBA-së nga rajoni la një boshllëk i cili po plotësohet nga aktorë të tillë si Rusia, Kina dhe Turqia, të cilët jo domosdoshmërisht mbështesin ambicien e rajonit për t'u integruar në institucionet Euro-Atlantike. Ndërsa nuk duhet shumë imagjinatë për të konkluduar se pse secili nga këta aktorë do të përpiqej të shfrytëzonte dobësitë e Perëndimit kurdo dhe kudo që të ishte e mundur, është tjetër pyetje nëse këto tre shtete (apo ndonjë aktor tjetër jo-Perëndimor në BP) kanë kapacitetin për të minuar perspektivën Euro-Atlantike të rajonit. Nëse e kanë, atëherë ndoshta ka të bëjë më shumë me dobësinë e Perëndimit sesa me forcën e këtyre aktorëve.

Për t'a kuptuar më mirë këtë bashkëveprim, ky projekt i vendos vetë aktorët e BP-së në qendër të kërkimit, duke u përpjekur që t'i analizojnë ata si pjesëmarrës aktivë dhe jo vetëm si subjekte pasive të veprimtarive të aktorëve të fuqishëm në Ballkanin Perëndimor. Projekti kërkon t'i përgjigjet dy pyetjeve të mëposhtme: cilat qëllime ndjekin vendet e BP-së dhe si ndërveprojnë ato me fuqitë Perëndimore dhe ato jo-Perëndimore në realizimin e këtyre qëllimeve?

Autorët e studimeve të përfshira në këtë projekt adresojnë këto pyetje nga këndvështrime të ndryshme, duke hedhur dritë mbi tema specifike nga media sociale deri tek degradimi i mjedisit, duke prezantuar çështje komplekse sociale dhe politike në lojë brenda shteteve individuale dhe duke përqendruar kërkimet e tyre në rolin e aktorëve vendas në kontekstin e ndikimit të huaj. Më herët, studime të ngjashme zakonisht shikonin aktivitetet dhe interesat e aktorëve

të jashtëm, duke mos i kushtuar vëmendje interesave aktuale të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Prandaj, qasja dominuese ka qenë analizimi i mjeteve që fuqitë jo-Perëndimore përdorin për të forcuar praninë e tyre në Ballkan, zakonisht nëpërmjet një përzierjeje të marrëveshjeve ekonomike, lidhjeve politike, përpjekjeve kulturore, depërtimit të medias, dhe në disa raste nëpërmjet aktiviteteve klandestine, të cilat i lejojnë atyre të fitojnë mbi qasjen më normative, pa imponimin e përdorur nga aktorët Perëndimorë, kryesisht BE-ja.

Qasja alternative, e ndjekur kryesisht nga studimet në këtë projekt, tregon se nuk është fuqia më e madhe e Rusisë, Kinës dhe Turqisë që lidhen me vetë vendet e BP-së që ka më shumë rëndësi, por më tepër fakti që BE-ja në përgjithësi nuk ka patur sukses në krijimin e lidhjeve të forta në rajon. Në një analizë të sofistikuar, Martin Naunov ilustron këtë pikë duke përshkruar se si BE-ja po dështon me partnerët e saj në Ballkan duke i marrë ata si të mirëqenë, duke humbur një mundësi për të mbështetur udhëheqësit progresivë dhe të orientuar drejt reformave. Duke zhgënjyer udhëheqësit progresistë, BE-ja në fakt po minon potencialin e saj të reformave në Ballkan.

Tërheqja e BE-së u ka mundësuar hapësirë më të madhe këtyre shteteve për të ndjekur interesat e tyre. Aktorët jo-Perëndimorë po marrin atë që mund të quhet "pre e lehtë" në një mjedis relativisht jokonkurrenues, jo për atë për të cilën do u duhej të luftonin me këmbëngulje. Sigurisht, përgjegjësia për të zbatuar reformat kërkuese bie mbi vendet e Ballkanit, por BE-ja do të ndihmonte më tej qëllimet e veta nëse do të identifikonte dhe mbështeste forcat pro-reformave dhe kështu partnerët e saj real në Ballkan.



## Ekonomia si motivuesi kryesor për bashkëpunim

Ky projekt gjithashtu ngre pyetjen nëse vendet e BP-së janë aktorë të pafuqishëm që lejojnë vetveten të shfrytëzohen nga aktorët e jashtëm, apo nëse ata gjithashtu angazhohen me aktorët e jashtëm për të maksimizuar fitimet sipas kushteve të tyre.

Tena Prelec i jep një përgjigje në mënyre prekëse kësaj pyetjeje duke shpjeguar nxitësit e politikës së jashtme të Serbisë, në dukje e çrregullt. Ajo pohon se politika e jashtme shumëdimensionale e Serbisë drejtohet kryesisht nga ndjekja e përfitimeve ekonomike, dhe në këtë mënyrë nga marrëdhëniet pragmatike me aktorë të ndryshëm, qofshin ata Perëndimorë apo jo-Perëndimorë, në mënyrë që të maksimizojnë përfitimet e saj ekonomike dhe kështu të zgjerojnë sensin e saj të sigurisë. Kjo qasje oportuniste apo pragmatike ndaj politikës së jashtme nuk është një fenomen i ri, pasi çdo vend përpiqet të zgjerojë sigurinë dhe

fuqinë e tij, me mirëqenien ekonomike në thelb. Gjithsesi, kjo qasje instrumentale ekonomike shtron një tjetër pyetje – me çfarë çmimi po arrihet zhvillimi ekonomik?

Ndonëse modeli ekonomik liberal po vihet në pikëpyetje në të gjithë globin, ai mbetet paradigma ekonomike dominante. Vendet e varfra nuk priten të vënë në pikëpyetje këtë paradigmë, nëse ishte një model i suksesshëm për pasurimin e vendeve të tjera në të kaluarën. Prandaj, domosdoshmëria për BP është zhvillimi ekonomik me pothuajse çdo kusht, pavarësisht shqetësimeve në lidhje me korrupsionin dhe ndotjen e mjedisit, për të cilat reflektojnë disa studime në këtë seri. Gjithsesi, BE-ja mund të shtyjë përpara avantazhin e saj në fushën e zhvillimit ekonomik duke patur parasysh burimet e saj të mëdha, si dhe të ndërhyjë për të ndihmuar vendet e BP-së të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme.

## Lidhjet historike dhe lidhjet emocionale

Studime të tjera në këtë projekt tregojnë se përfitimet ekonomike nuk janë e vetmja arsye pse vendet e BP-së kërkojnë partneritete me fuqitë jo-Perëndimore. Lidhjet historike dhe lidhjet emocionale gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në portretizimin e aktorëve të jashtëm si partnerë të elitave të brendshme. Analiza e Stefan Jojić për liderët politikë boshnjakë në rajonin Sanxhakut në Serbi tregon se ata favorizojnë marrëdhëniet me Turqinë pavarësisht mungesës së përfitimeve ekonomike për rajonin sepse ata përfitojnë prej saj nëpërmjet votuesve të tyre. Nëse shumica dërrmuese e boshnjakëve në Sanxhak e shohin Turqinë pozitivisht, posaçërisht si një fuqi tek e cila mund të mbështeten në kohë të vështira (pavarësisht mungesës së provave empirike për këtë besim), atëherë politikanët boshnjakë nuk mund të rrezikojnë të luhasin marrëdhëniet me Turqinë, edhe kur e vërejnë se kjo marrëdhënie ka përfitime ekonomike direkte të kufizuara.

Kritikët e rolit turk në Sanxhak (ose ndoshta në përgjithësi midis myslimanëve në BP) argumentojnë se kur presidenti turk Rexhep Tajip Erdoğan bën deklaratat rreth Ballkanit i cili është afër zemrës turke, këto duhet të kuptohen kryesisht si një mesazh për votuesit e tij në Turqi, në veçanti ata me prejardhje ballkanike dhe që janë të lidhur emocionalisht me këtë rajon. Në të njëjtën kohë, liderët politikë boshnjakë në Sanxhak (dhe në disa pjesë të tjera të Ballkanit) nuk mund të rrezikojnë të tjetërsojnë votuesit e tyre, të cilët e

shohin Turqinë në mënyrë të favorshme, duke kritikuar atë. Në linjë me këto gjetje, në punimin e saj mbi shqyrtimin e marrëdhënieve midis liderëve rajonalë shqiptarë dhe presidentit turk Erdoğan, Gentiola Madhi tregon se ‘miqësia’ e shpallur publikisht midis udhëheqësve bazohet në fakt tek interesat e tyre të brendshëm.

Mbështetja për Rusinë nga popullata e krishterë ortodokse mbështetet në të njëjtën mënyrë në ndjenjat pan-sllave dhe lidhjet historike. Jashtë kampit ortodoks, Rusia ka gjithashtu simpatinë e qytetarëve që favorizojnë krahasimin mes vlerave shoqërore tradicionale karshi atyre liberale dhe vlerësojnë liderët e fortë, duke parë presidentin rus Vladimir Putin si një kundërshtar të aftë të Perëndimit. Edhe Kina, si një relativisht e porsaardhur në BP, ka kapital emocional për të investuar, kryesisht në Serbi. Bombardimi i Beogradit nga NATO në 1999, ku u dëmtua ambasada kineze, mbart me vete kujtimin e vuajtjeve të ndërsjella dhe miqësisë kundër një armiku të përbashkët. Mosnjohja kineze e Kosovës është një tjetër pasuri që Serbia përdor për të forcuar marrëdhëniet me Kinën. Në punimin e tij, Stefan Vladislavljev dokumenton se si këto momente të rëndësishme historike kontribuan në forcimin e konsensusit për ruajtjen e partneritetit me Kinën si një nga përparësitë e politikës së jashtme edhe midis kundërshtarëve të regjimit të Aleksandër Vuçiçit.



Fuqia e butë jo-Perëndimore në Ballkan mbështetet në kujtimet e përbashkëta, një aset me vlerë për krijimin e lidhjeve me partnerët e mundshëm, por përpjekja kineze, turke ose ruse për të siguruar fuqi të fortë dhe të butë nuk bazohet vetëm në lidhjet emocionale. Kina e kupton këtë veçanërisht mirë dhe e bën bashkëpunimin ekonomik gur themeli të pranisë së saj në Ballkan. Rusia forcon pozicionin e saj karshi aktorëve Perëndimorë nëpërmjet bashkëpunimit energjetik, mbështetjes politike për liderët autoritarë dhe përmes ndihmës ushtarake. Turqia gjithashtu ka kuptuar se rivendosja e trashëgimisë kulturore osmane ka potencial të kufizuar për forcimin e prezencës së saj. Ajo ndërton lidhje ekonomike kur është e mundur, por është zgjeruar po ashtu edhe në fusha të tjera. Aktivitetet e kombinuara të aktorëve jo-Perëndimorë, veçanërisht në fushën e lidhjeve ekonomike dhe investimeve të huaja direkte megjithatë nuk i afrohen dot përfshirjes lokale të BE-së. BE-ja është deri më tani aktori më i fortë ekonomik lokal. Ajo gjithashtu mund të shfrytëzojë një rezervë vlerash të cilat i ndan me aktorët politikë dhe qytetarë në secilin shtet të BP-së. Kjo e bën dikë të pyesë veten nëse duke u dhënë fuqi joproporcionale aktorëve jo-Perëndimorë për të ndikuar në proceset politike dhe ekonomike në Ballkan, BE-ja në fakt po kërkon justifikim për tërheqjen e vet nga ky rajon.

Në këtë vëllim, Martin Naunov eksploron konceptin e orientimit nga partia, ku partitë politike nuk pasqyrojnë vetëm preferencat e votuesve të tyre, por gjithashtu

## Rivaliteti si një model politik

Punimet në këtë vëllim analizojnë marrëdhëniet dinamike midis Ballkanit Perëndimor, aktorëve Perëndimorë dhe jo-Perëndimorë ndërsa ata shpalosen dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie nuk janë statike dhe ato nuk ndodhin në mjedise të izoluar. Ekziston një potencial i mjaftueshëm për BE-në që të pohojë praninë e saj karshi aktorëve jo-Perëndimorë në Ballkanin Perëndimor, por mund t'a bëjë këtë vetëm nëse vlerëson në mënyrë kritike rolin e vet. Kjo do të thotë se BE-ja duhet të njohë disonancën midis ligjërit të vet normativ dhe veprimeve të politikave individuale të shteteve anëtare të BE-së.

Vendet e Ballkanit Perëndimor e shohin Gjermaninë që kritikon Rusinë rreth Krimesë dhe Ukrainës, ndërsa i reziston presionit për të ndaluar ndërtimin e Nord Stream II, i cili do t'i mundësojë Gjermanisë të blejë gazin rus me çmim të favorshëm. Një mori vendesh evropiane kritikojnë të dhënat kineze mbi të drejtat e njeriut, por më pas BE-ja miraton

i formësojnë ata në kontekstin e politik të Maqedonisë së Veriut. Për shembull, votuesit e VMRO-DPMNE-së në Maqedoninë e Veriut, ndonëse partia e tyre nominalisht ende mbështet integrimin Euro-Atlantik, kanë zvogëluar ndjeshëm mbështetjen ndaj këtij qëllimi si reflektim, natyrisht, i pengesave të përjetuara gjatë këtij integrimi, por edhe si rezultat i preferencave të brendshme të partisë që po përparon ligjërimin nacionalist dhe vlerat tradicionale jo-Perëndimore, si frymëzimi i tyre kryesor politik. Kjo disonancë konjitive mund të vërehet gjithashtu në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku disa parti të tjera nacionaliste nominalisht pajtohen me vlerat e demokracisë liberale dhe parimet e sundimit të ligjit, ndërsa në të vërtetë marrin vendime politike që minojnë vlerat dhe parimet e mbështetura zyrtarisht.

Ka diçka pa dyshim tërheqëse për qytetarët e BP-së kur shohin liderët e tyre duke mbështetur dy ose më shumë palë për të maksimizuar përfitimet nga secili prej tyre. Kjo sigurisht që nuk është unike vetëm për BP-në, pasi të gjithë aktorët politikë përdorin instrumentet që disponojnë për të arritur qëllimet e tyre të preferuara. Megjithatë, për sa kohë që BE-ja nuk i çmon këto dinamika të fuqisë dhe duhet të kuptojë se udhëheqësit politikë në Ballkanin Perëndimor qëndrojnë në pushtet duke luajtur në fusha të ndryshme, ata do të vazhdojnë të befasonen nga mospërputhja midis retorikës zyrtare dhe praktikës së politikës.

një Marrëveshje Gjithëpërfshirëse për Investime me Kinën që përfshin vetëm referenca të dobëta ndaj detyrimeve të kufizuara dhe jo-detyruese nga ana e Kinës për të përmirësuar kushtet për shoqërinë civile dhe kushtet e zbatimit të të drejtave të punës. Shtete anëtare të BE-së, si Hungaria, përfitojnë nga statusi i anëtarësisë në BE ndërsa minojnë në mënyrë efektive normat dhe vlerat e BE-së, për të cilat BE-ja nuk ka ndërmarrë kundërmasa efektive. Vendet e Ballkanit Perëndimor shohin vendet anëtare të BE-së që pengojnë procesin e zgjerimit të BE-së duke imponuar çështje dypalëshe ndaj vendeve kandidatë në kurriz të një politike të përbashkët të zgjerimit të BE-së. Ata shohin një politikë migrimi të BE-së në të cilën mbrojtja e të drejtave të njeriut zë vendin e dytë tek kërkesat e vendeve evropiane ku kufijtë e së cilëve qëndrojnë të mbyllur ndaj një fluksi më të madh migrantësh. Kriza e migrimit krijon një presion të frikshëm mbi vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët pritet të ndihmojnë migrantët dhe të parandalojnë lëvizjen e tyre





të mëtejshme të parregullt. Gjithsesi, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë zhvilluar ende strukturën e nevojshme institucionale për të ofruar ndihmë efektive dhe janë përballur me një situatë ku shumica e migrantëve nuk dëshirojnë të qëndrojnë në vendet e tyre. Rezultati është zhgënjimi, sepse Ballkani Perëndimor ndjen se ata pritet që të bëjë një punë 'të ndyrë' për BE-në në parandalimin e flukseve të migrimit, për të cilën ata nuk kanë as dëshirë dhe as kapacitete.

Nëse shtetet e Ballkanit Perëndimor shohin vendet anëtare të BE-së duke folur për norma ndërsa individualisht

kujdesen për interesat e tyre, ata do të bëjnë të njëjtën gjë. Nëse ata e shohin që BE-ja zyrtarisht mbështet zgjerimin, ndërsa në realitet tregon pak dëshirë për t'u angazhuar në mënyrë aktive dhe të vendosur me këto vende, të vlerësojë sfidat e tyre të brendshme, të kuptojë marrëdhëniet e tyre të jashtme historike dhe bashkëkohore, por në të kundërt vazhdon me një proces anëtarësimi nominal pa shumë entuziazëm, atëherë, liderët e Ballkanit Perëndimor do të vazhdojnë të kërkojnë dhe të mbështeten në partneritete përtej dhe, ndonjëherë, kundër BE-së.

## Çfarë mund të bëjë BE-ja?

Një seri studimesh të kohëve të fundit mbi temën e zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, të mbështetura gjithashtu nga gjetjet e autorëve në këtë projekt, tregojnë se BE-ja duhet të rishikojë qasjen e saj ndaj këtij rajoni dhe të kërkojë të ndërtojë partneritete të reja me aktorët vendas, përtej atyre të ndërtuar me zyrtarët. Partnerët e BE-së në Ballkanin Perëndimor duhet të jenë në radhë të parë qytetarë e tij. Liderët autoritarë nuk kanë asnjë nxitje për të ndërmarrë reforma, ndërsa qytetarët po. BE-ja duhet të kuptojë fuqinë që ka në rajon. Fuqia e saj ekonomike nuk përputhet me asnjë nga ato të aktorëve jo-Perëndimorë, as kapaciteti dhe udhëheqja e saj në sektorët e sigurisë dhe mjedisit, arsimit dhe shkencës, si dhe infrastrukturës së transportit dhe energjisë. Nëse BE-ja nuk arrin të maksimizojë përfitimet nga kjo pozitë e favorshme, kjo nuk është për shkak të forcës së aktorëve jo-Perëndimorë apo aftësisë së aktorëve lokalë të Ballkanit Perëndimor për të luajtur në fusha të ndryshme; do të jetë për shkak të mungesës së aftësisë së BE-së.

Gjetjet e autorëve të kësaj serie shënjestrojnë në të njëjtin drejtim. Ata tregojnë se BE-ja dhe Perëndimi kanë një pozicion të fuqishëm në Ballkan, ndonëse ky pozicion është sfiduar nga aktorë të tjerë. Ata gjithashtu tregojnë se politikanët lokalë përpiqen të maksimizojnë përfitimet që mund të marrin nga palë të ndryshme sepse në këtë mënyrë ata e paraqesin veten si liderë të aftë për popullit të tyre. Në këtë kontekst, siç pohon drejtë Martin Naunov, BE-ja duhet të marrë një vendim - ose të investojë në ndërtimin e partneriteteve të mirëfillta me forcat reformuese në Ballkan, ose të pranojë që fuqitë e tjera do të ndërtojnë partneritete të tyre.



# Konkluzione – Ndikimi i aktorëve të huaj në Ballkanin Perëndimor: Hapjet, Mbylljet dhe Perspektivat nga Brenda-Jashtë

Ioannis Armakolas

## Hyrje

Studimi i Ballkanit Perëndimor ka gjeneruar një numër të madh studimesh, të cilat përqendrohen tek roli i aktorëve të jashtëm, jo vetëm tek BE-ja, SHBA-ja dhe vendet Perëndimore, por gjithnjë e më shumë edhe tek vende të tjera (Bechev 2017; Bieber and Tzifakis 2020; Öztürk 2021). Përfshirja e aktorëve jo-Perëndimorë në Ballkan sigurisht nuk është një histori e re dhe nuk mund të ketë qenë, pasi disa prej tyre, të tillë si Turqia dhe Rusia, kanë një histori të vjetër prej shekujsh dhe traditë të pranishme dhe rolit në rajon. Por gjatë viteve të fundit, një sërë zhvillimesh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve sërish. Së pari, është fillimi i Kinës për herë të parë në rolin e një fuqie globale që mund të vërë në pikëpyetje politikën dhe narrativën perëndimore në lidhje me rajonin. Së dyti, është dobësimi i perspektivës evropiane të rajonit dhe në të njëjtën kohë problemet e vazhdueshme politike, ekonomike dhe të sigurisë në Ballkanin Perëndimor që stimulojnë kërkesën për ide të reja, politika të reja dhe jo më pak aktorë të rinj. Dhe së treti, është gjithashtu rritja e numrit të aktorëve të interesit, përtej të mirënjohurve Rusi, Kinës dhe Turqi, që gjeneron më shumë vëmendje kërkimore. Ndonëse ata ende nuk tërheqin aq shumë interes kërkimor sesa treshja e spikatur, studimet e reja janë përqendruar tek Irani (Bishku 2016; Koppa 2020), Emiratet e Bashkuara Arabe (Bartlett and Prelec 2020; Bartlett et.al. 2017; Prelec 2020b), Arabia Saudite (Koppa 2020; Lilyanova 2017) dhe vendet e Gjirit në përgjithësi (Ejdus 2017; Mandaci 2017).

Projekti Ballkani në Udhëkryq ka prodhuar një numër perspektivash të reja interesante që përqendrohen tek angazhimi i aktorëve jo-Perëndimorë në Ballkanin Perëndimor. Këto studime janë përpiluar në këtë vëllim, i cili ka ambicien për të dhënë një kontribut të ri për hulumtimin e përgjithshëm rreth Ballkanit Perëndimor. Studimet e përfshira në këtë vëllim kanë tre përparësi të rëndësishme, në krahasim me shumë punime të tjera. Së pari, ndryshe nga shumica e përgjithshme e studimeve shkencore dhe të orientuara drejt politikave, kapitujt në këtë vëllim thellohen

tek substanca e përfshirjes së fuqive të jashtme në Ballkan. Sigurisht ekzistojnë studime të shumta që tregojnë deri më tani mbi investimet e mirënjohura kineze apo përpjekjet e Turqisë për të rritur gjurmën e saj në rajon. Por, shumica e studimeve ekzistuese nuk shtjellojnë në detaje dimensionet e ndryshme të angazhimit të këtyre shteteve me rajonin. Ky vëllim përfshin një numër rastesh studimore që reflektojnë detajet dhe shpjegojnë mekanizmin e saktë të ndikimit më të gjerë të politikave të aktorëve jo-Perëndimorë në rajon. Së dyti, studimet e përfshira në këtë vëllim janë të fokusuara tek përmbajtja aktuale dhe empirike, si dhe tek efektet anësore të përfshirjes së fuqive të jashtme në hartimin e politikave dhe në rrethanat socio-ekonomike, në vend që të rrëfejnë mantrën e përgjithshme të përsëritur shpesh për ndikimin e tyre 'malinj'. Këto studime natyrisht nuk i shfaqësojnë politikën jo-Perëndimore nga ndikimi i tyre negativ, por dëshirojnë të tregojnë se në çfarë mase dhe si ato krijohen në realitet. Së treti, ky vëllim paraqet studime që bazohen në një mori të dhënash empirike, shpesh të mbledhura në rrethana sfiduese gjatë pandemisë COVID-19, dhe nuk përdorin thjesht zhvillime të mirënjohura dhe të dhëna të disponueshme në studime të tjera të ngjashme.

Në këtë kapitull përmblyës, ne përiqemi të ofrojmë njohuri se si kapitujt e këtij vëllimi mund të avancojnë kuptimin tonë mbi ndikimin pragmatik të politikave dhe të ndërhyrjeve të aktorëve të jashtëm. Për t'a bërë këtë, ne i klasifikojmë studimet në tre kategori tematike, të cilat unë besoj se ofrojnë kënde të reja të vlefshme. Kategoria e parë, të cilën ne e quajmë këtu 'Hapjet', na ftojnë të rimendojmë situatën aktuale gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor, duke evidentuar alternativa ndaj vizionit perëndimor për përfshirjen e plotë në institucionet perëndimore. Këto alternativa mund të nënkuptohen ose edhe të planifikohen nga fuqitë jo-Perëndimore, ose ato mund të burojnë nga zhvillime që nuk varen nga vet shtetet. Gjithsesi, pika e konvergencës është se të gjitha këto dinamika, të synuara ose



jo të qëllimshme, kontribuojnë në dobësimin e ndikimit Perëndimor në rajon dhe në forcimin e rolit të të tjerëve.

Kategoria e dytë, të cilën ne e quajmë këtu 'Mbylljet', prezanton drejtimin e kundërt. Këto janë raste dhe zhvillime që evidentojnë kufizimet, dështimet ose thjeshtë dimensionet negative të veprimtarive dhe të politikave të fuqive jo-Perëndimore. 'Mbylljet' në mënyrë të pashmangshme i bëjnë shumë të rimendojnë nëse ndikimi jo-Perëndimor duhet të mirëpritet dhe të rivendoset vizioni politik perëndimor dhe mendimin gjeopolitik për Ballkanin Perëndimor në vendin e vet pararendës dhe origjinal.

Kategoria e tretë, e quajtur këtu 'Nga Brenda-Jashtë', zhvendos vëmendjen nga mundësitë gjeopolitike dhe dështimet e aktorëve jo-Perëndimorë në mënyrën se si palët e interesuara negociojnë ndikimet e jashtme në nivelin e brendshëm, kombëtar dhe lokal. Kjo perspektivë, pra, e kthen vëmendjen tonë nga roli dhe politikat e aktorëve

të jashtëm tek perspektivat, perceptimet, interesat dhe preferencat politike të aktorëve në rajon. Në kuptimin e tij më standard, ky dimension është referuar në literaturë si shpjegimet për ndikim të huaj 'nga ana e kërkesës'. Kjo 'kërkesë' përbën frymëzimin origjinal për perspektivën 'nga brenda-jashtë' të propozuar në këtë kapitull. Por, përmbajtja aktuale këtu është disi më e thellë dhe më e gjerë, në sensin që merr 'më seriozisht' aftësinë dhe dëshirën e aktorëve të brendshëm për të formësuar në mënyrë aktive marrëdhëniet me aktorët e jashtëm dhe efektet e gjurmëve të tyre në rajon. Si dhe pse ky 'thellim' është i preferueshëm për analizën do të shtjellohet në seksionet përkatëse. Mjafton këtu të përmendim se perspektiva 'nga brenda-jashtë' do të ndahet në dy nën-kategori të ndryshme: a) njëra që i përket 'strategjive politike dhe aktoritetit' të aktorëve të brendshëm, dhe b) tjetra që përqendrohet tek 'rrefimet dhe mjetet' e përdorura nga palët e interesuara të brendshme kur ato negociojnë rolin dhe ndikimin e fuqive të jashtme për objektivat dhe axhendat e tyre.

## Hapjet

Një sërë studimesh dhe shembujsh nga projekti Ballkani në Udhëkryq janë përpjekur të shpjegojnë zhvillimet të cilat nënkuptojnë një ndryshim ndërkombëtar thelbësor në mjedisin politik të Ballkanit Perëndimor si rezultat i angazhimeve të fuqive të huaja të reja. Ato gjithashtu janë përpjekur të tregojnë mekanizmat përmes së cilave ndodhin ngatërresa të tilla midis ndikimeve të huaja të vjetra dhe të reja. Në këtë seksion, të emërtuar 'Hapjet', ne kontrollojmë këto shembuj dhe raste. Për qëllimet e studimit tonë, ne i shohim këto ide dhe zhvillime si leva të mundshme që mund t'u ofrojnë mundësi aktorëve të huaj për rimodelim të panoramës gjeopolitike të Ballkanit Perëndimor, në drejtim të dobësimit të rolit dhe ndikimit të Perëndimit dhe të forcimit të atyre të fuqive jo-Perëndimore.

Si fillim, kriza e COVID-19 ka përshpejtuar përballjet gjeopolitike në rajon, duke përkeqësuar problemet e mëparshme të sigurisë, etnike, politike, ekonomike dhe sociale (Latal 2020a, 17). Momenti i përshtatshëm për fuqitë jo-Perëndimore u mundësua ose u lehtësua nga reagimi i hershëm letargjik dhe i papërshtatshëm i BE-së ndaj krizës dhe politikave kundër-produktive të presidentit të mëparshëm amerikan. Siç vëren Srećko Latal, zhvillimet dhe konkurrenca e fuqive të mëdha të shkaktuara nga pandemia mund të "turpërojnë edhe thrillerët më të mirë politikë" (Latal 2020a, 7). Kina, Turqia, vendet e Gjirit, Rusia, SHBA-ja dhe sigurisht BE-ja janë përfshirë në një luftë me tërheqje për të

fituar ose për të ruajtur avantazhet gjeopolitike, duke ofruar ndihmë për qeveritë në siklet dhe për sistemet e kujdesit shëndetësor të Ballkanit Perëndimor. Ndonëse BE-ja është aktori i vetëm ndërkombëtar në gjendje të ofrojë një vizion gjithëpërfshirës për përfshirjen e rajonin në qarkun e vet, vonesat dhe dështimet e saj, sërisht nën reflektor gjatë pandemisë, ofruan mundësi për aktorët e tjerë (Latal 2020b). Çarjet në vizionin dhe performancën e BE-së janë sigurisht një histori e parathënë. Siç vëren Latal (2020b, 16), "historia e marrëdhënieve BE-Ballkan tregon se ndikimi politik i BE-së në rajon mbeti shumë larg angazhimit të saj financiar masiv, shpesh i njollësuar nga keqkuptime dhe mosbesim të ndërsjellë, sikurse nën hijen e përfshirjes politike, fetare ose kulturore të aktorëve të tjerë".

Ndoshta një aktor global që u duk se fitoi më shumë në Ballkanin Perëndimor nga kjo krizë ka qenë Kina. Anastas Vangeli (2021a) tregon se perceptimi i rolit të Kinës dhe dëshira për angazhim me Kinën ka evoluar që nga fillimi i krizës së COVID-19. Faza fillestare, gjatë së cilës pandemia shoqërohej kryesisht me Kinën ndërkombëtarisht dhe kurthet e pretenduara mbi menaxhimin e krizës nga Pekini, shtetet e Ballkanit Perëndimor ndoqën pjesën tjetër të botës me skepticizmin e tyre ndaj rolit kinëz. Gjatë fazës së dytë ('diplomacia e maskave'), shtetet e Ballkanit Perëndimor ishin më të gatshëm të angazhoeshin me Kinën për shkak të përfitimeve të mundshme në



parandalimin e efekteve të pandemisë dhe duke pasur parasysh ngadalësinë e ndihmës së BE-së, por ende shumica e tyre mbajtën një qëndrim ambivalent ndaj Pekinit. Gjatë fazës së tretë ('diplomacia e vaksinave'), shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor filluan të pranojnë, ndonëse me ngurrim, se bashkëpunimi me Kinën mund të ishte vendimtar.

Është e qartë se, në kontrast me shumicën e shteteve të Ballkanit Perëndimor që ndoqën qasjen e kujdesshme dhe nguruese, Serbia u shqua për investim të kapitalit politik dhe energjisë në një angazhim intensiv dhe bashkëpunim me Kinën. Ishte një bast që u kritikua shumë nga BE-ja, madje edhe nga politikanët në Ballkanin Perëndimor. Por, ishte një bast që duket se, të paktën në momentin e shkrimit të kësaj analize, është fituar. Duke pasur parasysh shtrirjen e ngadaltë të vaksinave në vet BE-në, madje edhe më të ngadalë në Ballkanin Perëndimor, Serbia u vet shpall një nga vendet model të vaksinimit në Evropë. Strategjia e Presidentit Vuçiq për të mos u mbështetur në sistemin e BE-së dhe në të kundërt, rënia dakord për dërgesat nga Rusia dhe Kina gjithashtu - një jehonë gjatë COVID-19 e politikës së jashtme multi-vektoriale të Serbisë - shënoi një fitore të madhe të PR-it kur Serbia vendosi vaksinat e saj në dispozicion të fqinjëve nga Ballkani Perëndimor. Kur mijëra njerëz nga vendet fqinje kapërcyen kufijtë e Serbisë për t'u vaksinuar, shumë njohën një turp të BE-së dhe të politikave të saj joefektive në rajon (Hopkins 2021).

Studimi i Vangeli-t (2021a) u botua para kësaj fitore të rëndësishme serbe. Por analiza e tij tashmë kishte shfaqur strategjinë ndryshe të Serbisë. Vangeli e quajti qasjen e Serbisë në "kërkim aktiv të mundësive", "në kundërshtim me qasjen nën radar të qeverive të tjera, e cila varionte midis oportunitetit dhe kujdesit" (2021a, 3). Analiza e Vangeli-t përshkruan katër lloje të ndryshme ideale të qëndrimeve ndaj Kinës gjatë pandemisë COVID-19: (1) kërkim aktiv të mundësive; (2) shfrytëzim të kujdesshëm të mundësive; (3) alarmizëm aktiv; dhe (4) shmangie e kërcënimit. Përfundimi i tij interesant tregon se pak aktorë kanë adoptuar angazhim apo opozitë 'ekstreme' dhe të zëshme/të dukshme ndaj Kinës (Vangeli 2021a, 13-14). Qeveria serbe ishte e vetmja në rajon që miratoi strategjinë e 'kërkimit aktiv të mundësive', e cila vlerësoi Kinën dhe investoi shumë për bashkëpunim dhe ndihmë nga Pekini. Ishte gjithashtu e vetmja që antagonizoi dhe përçmoi hapur BE-në për politikën e saj ndaj COVID-19 në Ballkan (Simic 2020), një perspektivë që u reflektua edhe në mediat serbe, e cila ishte shumë e njëanshme kundër BE-së dhe në favor të Kinës (Burazer et.al. 2021). Në skajin tjetër të spektrit, vetëm shoqëria civile

pro-Perëndimore dhe pro-evropiane në rajon ishte 'alarmisti aktiv', pra e zëshme në kundërshtimin e saj ndaj Kinës dhe në kundërshtimin e bashkëpunimit dhe ndihmës mbi baza gjeopolitike.

Qeveritë e tjera të rajonit ndoqën një qasje më pragmatike që kërkonte të mos tjetërsonte Kinën, pavarësisht nga qëndrimi i tyre ndaj çështjes së bashkëpunimit dhe ndihmës. Vangeli e klasifikon këtë qasje në kategorinë 'nën radar' dhe identifikon dy lloje qasjesh: 'përdorimi i mundësisë së kujdesshme', e cila angazhohet me Kinën pa qenë shumë e zëshme për këtë dhe 'shmangia e kërcënimit', e cila shmang bashkëpunimin me Kinën, por përsëri pa 'shumë zhurmë'. Klasifikimi i Vangeli-t është i dobishëm pasi na lejon të shohim evolucionin e politikave qeveritare në rajon. Me sa duket, ndryshe nga Serbia, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor ndoshta preferuan të mbështeten tek BE-ja, aktori kryesor për orientimet e politikës së tyre të jashtme. Por paaftësia e BE-së për të siguruar dërgesa në kohë në sasi të mjaftueshme, sikurse diplomacia e suksesshme e vaksinave të Serbisë, bënë që disa qeveri të rishikonin preferencat e tyre të mëparshme dhe të zgjidhnin një qasje më të ekuilibruar me shpresën e rikuperimit të shpejtë nga efektet më të këqija të pandemisë (p.sh. Reuters 2021). Megjithatë, pavarësisht nëse një qeveri qëndroi në anën e pranimit apo të refuzimit të bashkëpunimit, pragmatizmi çoi në ruajtjen e një profili të ulët në lidhje me të.

E megjithatë, kritikët do të argumentonin se duke u përqëndruar me tepri tek roli i pandemisë COVID-19, diku sh do të humbiste zhvillimet më të gjera makro-historike rreth përfshirjes së Kinës në Ballkanin Perëndimor. Vangeli në të kundërt do të argumentonte se "Kina tashmë ka një ndikim të rëndësishëm ideor në mënyrën se si elitat në rajone të ndryshme mendojnë jo vetëm për ekonominë politike globale, por edhe për rolin e tyre në të" (2021b, 3), dhe se ky është edhe rasti i Ballkanit Perëndimor. Vangeli e kupton ndikimin ideor të Kinës si "formësues i kontekstit", në sensin që ajo ripërcakton "parametrat e çka është e mundur shoqërisht, politikisht dhe ekonomikisht për të tjerët" (Vangeli 2021b, 6). Dhe ai analizon çështjen e këtij ndikimi ideor në dy nivele të ndryshme: duke u përqëndruar në çështjen e qëllimshmërisë dhe në shkallën e ndërmjetësimit (ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë). Në këtë mënyrë, analiza përfshin të dy ndikimet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e drejtpërdrejta të shteteve të Ballkanit Perëndimor me Kinën dhe platformat e saj kryesore, si dhe më gjerë kuptimet e të njëjtave shtete për çështjet globale dhe vendin dhe ndikimin e Kinës në to.



Katër rrugët e ndryshme të identifikuar nga analiza e Vangeli-t ofrojnë dimensione të shumëfishta për të analizuar marrëdhëniet e ndërlikuara midis Kinës dhe Ballkanit Perëndimor. Ato tregojnë, për shembull, se ndikimi kinez u sfidua nga njohuritë dhe stereotipet ekzistuese dhe të qëndrueshme, ndërsa marrëdhëniet e reja u ndërmorën nganjëherë nga elitat politike, por jo domosdoshmërisht ishin të pranuar nga qytetarët në Ballkanin Perëndimor. Në mënyrë të ngjashme, çështja e rolit kinez u bë një çështje e kontestuar ashpër në politikën e brendshme, e cila kufizoi potencialin për ndikim të Kinës, ndërsa pa dashje implikonte kinezët në antagonizmat dhe konkurrencën e brendshme politike, e cila nuk varej natyrisht prej tyre ose nën kontrollin e tyre.

Mandej, elitat politike kishin një vështrim instrumental mbi rolin kinez, që nënkuptonte se ata mirëpritnin përfitimet praktike të marrëdhënies me gjigantin aziatik pa vënë në pikëpyetje preferencat e tyre më të gjera gjeopolitike ose duke pranuar pikëpamjen transformues globale të Kinës. Fakti që bëhet gradualisht më e qartë se në marrëdhëniet me Kinën, ose më gjerë në orientimet gjeopolitike, “nuk

mund t’a kesh tortën tënde dhe gjithashtu t’a hash atë”, ka të ngjarë t’a bëjë ndikimin më të madh të Kinës më pak të shijshëm. Prandaj, ky element gjithashtu tregon në masë të madhe kufizimet e ndikimit ideor të Kinës, çka vë në dyshim rezultatet transformuese që me sa duket ishin synuar ose ëndërruar nga Pekini. Kjo kontradiktë midis rezultateve të synuara dhe realiteteve të aktorëve ballkanikë “buron nga besimi (ose më mirë dëshira) se bashkëpunimi ekonomik kino-ballkanik në rritje mund të arrihet pa shkakuar ndonjë shqetësim të rëndësishëm në status quo-në gjeopolitike. Në të kundërt, mosndikimi më i rëndësishëm ideor midis elitave të Ballkanit Perëndimor ka qenë mosnjohja e pikës ku rritja e Kinës dhe aftësia e saj për t’u bërë një aktor ekonomik në rajon është së pari rezultat i një trazire të status quo-së” (Vangeli 2021b, 18). Me mirëkuptimin se angazhimi më i thellë me Kinën ka implikime gjeopolitike, si të synuara nga Kina si dhe të paqëllimta, dhe mund të rezultojë në një strategji të rrezikshme, pason edhe një ngurrim nga shumë elita politike ballkanike. Siç vëren Vangeli, “disa janë gati të përqafojnë rrezikun, ndërsa të tjerë kërkojnë mënyra për t’a shmangur atë” (Vangeli 2021b, 18).

## Mbylljet

Ky seksion në një farë mënyrë ndjek një këndvështrim të kundërt. Nëse seksioni i mëparshëm prezantonte ‘hapjet’ ose mundësitë për ndikim më të madh jo-Perëndimor, ky do të tregojë anën negative të së njëjtës histori. Me ‘Mbyllje’ ne konsiderojmë shfaqjet e ndikimit jo-Perëndimor, të cilat ilustronë kufizimet e këtyre aktorëve, dështimet e tyre ose evidentojnë ndikimin negativ. Të njëjtat shfaqje kujtojnë ose rikthejnë një rol më ‘beninj’, dhe në fund të ditës të preferueshëm nga partnerët perëndimorë. Me ‘mbylljet’, me fjalë të tjera, ne përshkruajmë zhvillimet që kufizojnë hapësirën për alternativa dhe rikthejnë Ballkanin Perëndimor përsëri në vizionin gjeopolitik dhe politik, i cili u vendos pas përfundimit të luftërave jugosllave dhe synon t’a vendosë rajonin në një rrugë të fortë drejt demokracisë liberale dhe integritimit në institucionet perëndimore.

Ne do të shmangim këtu etiketimin ‘ndikim malinj’, i cili nuk është i pazakontë në qarqet e politikës perëndimore dhe analizat e think tankeve (p.sh. Pyatt 2021). Sikurse do të bëhet më e qartë në këtë seksion, kjo qasja e ‘kalorësit të zi kundër kalorësit të bardhë’ nuk ndihmon në kuptimin tonë të proceseve komplekse të përfshirjes së fuqive të huaja jo-Perëndimore në rajon. Në të kundërt, nëpërmjet ‘mbylljes’ ne i referohemi një ngushtimi të hapësirës së

ndikimit të aktorëve të huaj jo-Perëndimorë, i cili sidoqoftë bazohet në mangësitë e botës reale të atyre sistemeve që promovojnë këto ndërhyrje dhe ndonjëherë çojnë drejt rezultateve sub-optimale ose potencialisht të dëmshme.

Për fillestarët, një shembull i shqyrtuar nga projekti Ballkani në Udhëkryq ka qenë bashkëpunimi i qeverisë serbe me Huawei-n e Kinës në kuadër të projektit ‘Qytet i Sigurt’, një projekt i cili mund të përfaqësojë për disa “shumën e të gjitha frikave” (Bjeloš 2020). Çka habit është bashkimi i prezantimit të teknologjisë së përparuar të mbikëqyrjes, e cila përfshin software të njohjes së tipareve të fytyrës, me origjinë nga një vend autoritar i mirënjohur për përdorimin e tij të teknologjisë për qëllime të mbikëqyrjes sociale, në një vend evropian që po i zbrapset procesit të konsolidimit të tij të demokracisë (European Commission 2020; Bieber 2020; Pavlovic 2020). Maja Bjeloš (2020) prezanton rreziqet e futjes së teknologjive të tilla në një vend me kontrolle dhe ekuilibra jo të përshtatshëm. Më e rëndësishmja, ajo paraqet hendekun në rritje të perspektivave midis qeverisë serbe dhe shoqërisë civile aktive serbe. I pari shtyn me vetbesim agjendën e ‘Qytetit të Sigurt’, duke e portretizuar atë si një projekt modernizues për vendin, i cili do të ndihmojë në luftën kundër krimit dhe terrorizmit. Në të njëjtën



kohë, qeveria e ka mbajtur projektin jashtë mbikëqyrjes demokratike dhe asaj qytetare, duke e ruajtur atë nën statusin e 'informacionit të klasifikuar'. Shoqëria civile është shumë kritike për mënyrën se si këto teknologji janë prezantuar dhe tregon rreziqet e keqpërdorimit të tyre nga shteti dhe qeveria e momentit. Ajo gjithashtu thekson mungesën e legjislacionit të përshtatshëm për të garantuar liritë dhe të drejtat. Dhe së fundmi, ajo gjithashtu bën thirrje për një debat kombëtar mbi implikimet ligjore, politike dhe sociale të zbatimit të teknologjive të mbikëqyrjes inteligjente.

Në këtë drejtim, shoqëria civile serbe është e përpiktë. Sikurse në shumë vende, opinioni publik nuk është i informuar në mënyrë të përshtatshme dhe ka vështirësi në kuptimin e implikimeve që teknologji të tilla të përparuara mund të kenë për jetën e qytetarëve të zakonshëm, si dhe për shëndetin e institucioneve demokratike. Në të kundërt, qytetarët e zakonshëm, të keq informuar dhe pa dyshim të ndikuar nga raportimet pro-Kinë në mediat e kontrolluara nga qeveria, duket se lejojnë qëndrimet e tyre pozitive ndaj Kinës (Bjeloš, Vuksanović and Sterić 2020) duke lënë në hije rreziqet e projektit 'Qyteti i Sigurt'.

Fakti që projekti vazhdoi i palodhur, dhe madje u intensifikua gjatë pandemisë së COVID-19, tregon se qeveria serbe nuk do të tërhiqet pavarisht kritikave të shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë, çështja ngre pyetjen se sa BE-ja mund të ndikojë në një vend që po negocion anëtarësimin drejt konsolidimit demokratik (Dzankic et. al. 2019). Literatura kryesore e studimeve evropiane (Grabbe 2006; Vachudova 2005) pohon se ndikimi i tillë i BE-së është i lartë pikërisht në fazën ku Serbia gjendet aktualisht, d.m.th. kur vendi po negocion hapjen dhe mbylljen e kapitujve të ndryshëm. Gjithsesi, duket se ky ndikim ka qenë duke u zbehur në rastin e Serbisë, ndërsa vetë monitorimi i Komisionit Evropian ka bërë pak për të theksuar nevojën që Serbia të përputhet me praktikën evropiane për këtë çështje (p.sh. European Commission 2020), ose për të dekurajuar qeverinë serbe nga futja e shpejtë e sistemeve të mbikëqyrjes inteligjente.

Në një tjetër studim të botuar nga projekti Ballkani në Udhëkryq, Tena Prelec (2021) demonstron se si disa nga investimet më ikonike kineze në Ballkan janë përfshirë në shembuj të shquar ose më pak të njohur rreth ndikimit të jo të favorshëm në mjedis, një temë kjo, që siç vëren autorja, nuk ka marrë vëmendje akademike të barabartë me dimensionet më gjeopolitike të pranisë së Kinës në rajon (por shihni gjithashtu Tsimonis et al. 2020). Për Prelec, narrativa standarde e investimeve 'kinezët të këqinj kundër Perëndimorëve të mirë' është shumë e thjeshtëzuar

për të kapur nuancat e brendshme të procesit. Problemet mjedisore në qytetet e hetuara ekzistonin edhe para 'pushtimit' kinez të industrive të rënda lokale. Investitorët e mëparshëm perëndimorë gjithashtu nuk mund të shfajësohen nga përgjegjësitë për situatën e rëndë, ndërsa efektet anësore negative të "programeve të reformës neoliberale të hartuara ose të zbatuara jo në mënyrën e duhur" duhet gjithashtu të faktorizohen (Prelec 2021, 6). Gjithashtu, vetë BE-ja ende nuk e vendos lartë në agjendën e marrëdhënieve me Serbinë çështjen e efekteve mjedisore negative të investimeve kineze. Dhe kjo është pavarësisht faktit se, në përgjithësi, legjislacioni dhe politikat e energjisë të qeverisë serbe duket se ndryshojnë qartë nga standardet e vendosura për objektivat e tranzicionit energjetik të BE-së, si dhe ato të Komunitetit të Energjisë, për të cilat Serbia është nënshkruese.

E megjithatë, Prelec tregon qartë se si situata është përkeqësuar në vitet e fundit nën pronësinë kineze të këtyre industrive kryesore, ndërsa komunitetet lokale dhe qytetarët aktivistë janë mobilizuar gjithashtu në përgjigje të përkeqësimit të kushteve mjedisore nën drejtimin e kinezëve. Analiza e Prelec arrin ndoshta maksimumin e saj kur paraqet nuancat në marrëdhëniet e kino-serbe të qeverisë dhe ekuilibrin e përgjegjësisë. Ashtu si edhe në rastin e projektit 'Qyteti i Sigurt', panorama e synimeve dhe interesave është më e ndërlikuar sesa konceptimet 'bardh e zi' për kinezët karshi 'ndikimit nga jashtë-brenda' mbi aktorët e brendshëm politikë 'të dobët'. Në të kundërt, Prelec tregon se rezultatet negative të politikës janë një bashkim veprimesh dhe interesash si të aktorëve të huaj dhe atyre vendas, ose siç e quan ajo, duke ndjekur Tsimonis et. al. (2020), një 'sinergji dështimesh'. Në fund të ditës, janë synimet, interesat, dobësitë dhe dështimet e elitave dhe institucioneve të brendshme ato që mundësojnë pasoja të mundshme negative të veprimtarisë ekonomike të huaj, pa marrë parasysh se cilat mund të kishin qenë fillimisht synimet e aktorëve të huaj. Dhe anasjelltas, është "cilësia e qeverisjes së vendit mikëpritës [që] ka më shumë rëndësi sesa praktikata e aktorit të huaj për të siguruar që investimet të jenë transparente dhe të dobishme për të gjithë popullsinë" (Prelec 2021, 6).

Është interesant fakti që tendencat e fundit të ndikimit të huaj në rajon kanë prodhuar në mënyrë kurioze edhe mbyllje kundër-intuitive, të cilat rrezikojnë të minojnë marrëdhëniet që më parë ishin në një pozitë të mirë. Marrëdhëniet e Turqisë me shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë qenë tradicionalisht të bazuara në përfitime reciproke, legjitime dhe të bazuara tek historia. Por kthesa joliberalë e Turqisë (Öktem and Akkoyunlu 2019) dhe rritja



e centralizimit të Presidentit turk Rexhep Tayyip Erdoğan në politikën e jashtme turke (Görener and Ucal 2011; Kesgin 2020) kanë modifikuar marrëdhëniet me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Punimi i Gentiola Madhit (2021) analizon zhvillimet e fundit të marrëdhënieve midis Turqisë dhe dy shteteve me shumicë shqiptare në rajon, Shqipërisë dhe Kosovës, një marrëdhënie që më parë kishte qenë shumë pozitive dhe shumëplanëshe. Gjithsesi në vitet e fundit, marrëdhëniet dypalëshe kanë marrë një kthesë “diplomatike personale”, me udhëheqësit e Shqipërisë dhe Kosovës, Kryeministrin Edi Rama dhe Presidentin e mëparshëm Hashim Thaçi respektivisht, dhe Presidentin Erdoğan duke kultivuar marrëdhënie të veçanta personale që shkojnë përtej marrëdhëniet miqësore normale dhe tipike të shteteve të tyre përkatëse.

Madhi tregon se si marrëdhëniet e tilla personale kanë kuptim në kontekstin e strategjive politike personale të të tre udhëheqësve, por që mund të rezultojnë kundërproduktive për interesin kombëtar të palës më të dobët në këtë marrëdhënie, të cilat natyrisht janë dy vendet e Ballkanit Perëndimor. Siç vëren Madhi, “[në] prezencë të sistemeve të dobëta qeverisëse, qasja e ‘diplomacisë personale’ mund të lehtësojë aksesin në çështjet qeveritare të vendeve të tjera nëpërmjet trajtimeve preferenciale, të tilla si tendera për investime, çka zbeh vijën ndarëse midis çështjeve të jashtme dhe atyre të brendshme” (2021, 4). Autorja fokusohet në dy çështje të veçanta, të cilat përbëjnë konsiderata politike kryesore për Turqinë e Erdoğanit, por që kur eksportohen si probleme dhe kërkesa politike tek shtetet e Ballkanit Perëndimor, mund të rrezikojnë ekuilibrin e tyre të brishtë shoqëror ose të rrezikojnë institucionet e dobëta demokratike dhe shtetërore; dy çështjet janë agjenda fetare e Turqisë dhe shpërbërja e qarqeve dhe institucioneve gyleniste jashtë vendit. Përgjigjet e të dy vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj këtyre prioritetëve të politikës së Turqisë nuk kanë qenë identike: “Në rastin e Shqipërisë, Kryeministri Rama ka ndjekur një qasje ambivalente karshi agjendës së Turqisë dhe koncesionet e tij ndaj kërkesave turke kanë qenë shpërblyer si duhet. Ndërsa, në rastin e Kosovës, miqësia e Thaçit me Erdoğanin ka rezultuar më pak e ekuilibruar përse i përket fuqizimit të ndërsjellë. Plotësimi i kërkesave turke ka rezultuar në një shfrytëzim të dobësive të brendshme të Kosovës në favor të agjendës korrozive turke” (Madhi 2021, 3).

Dhe ndërsa Edi Rama ka qenë më rezistent ndaj përpjekjes së Turqisë për të ndërhyrë në politikën e brendshme të dy shteteve të Ballkanit Perëndimor, në ekuilibër të dy liderët i kanë dhënë koncesione Turqisë në këmbim të

mbështetjes politike nga Erdoğan ose thithjes së fondeve turke (Madhi 2021, 16). Mbështetja e fundit e dhënë nga udhëheqësi turk për kryeministrin shqiptar përpara zgjedhjeve kritike parlamentare të prillit 2021 është një tjetër rast. Mbështetja përfshinte ndërtimin nga Turqia të një spitali të ri në Shqipëri për vetëm tre muaj dhe pikërisht për inaugurimin e tij disa ditë përpara zgjedhjeve kritike të prillit 2021 (Daily Sabah 2021). Në përgjithësi, siç shpjegon Madhi, të dy miqësitë e veçanta “janë promovuar në bazë të një kongruence të përkohshme interesash dhe përfitimesh politike të llogaritura, duke mospasur kështu një bazë strukturore për një institucionalizim në nivelin shtetëror” (2021, 3), ndërsa edhe zhvillimi i këtyre marrëdhënieve tregon se pak mund të pritët për shndërrimin e “lidhjeve personale të udhëheqësve në marrëdhënie institucionale më të qëndrueshme” (2021, 16).

Në fund të ditës, duke pasur parasysh kthesën autoritare të Turqisë dhe dobësimin e fuqisë dhe ndikimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, “vëllazërimi i liderëve të shteteve” mund të ketë efekte korrozive tek demokracitë ende të dobëta të Shqipërisë dhe Kosovës. “Vizitat e shpeshta të liderëve shqiptarë në Ankara dhe Stamboll dhe takimet me dyer të mbyllura me presidentin turk kanë arritur të anashkalojnë të gjitha procedurat tradicionale të vendimarrjes dhe gjurmimit të administratave shtetërore, duke mosrespektuar transparencën publike dhe standardet të përgjegjësisë së qeverisë” (Madhi 2021, 16). Ajo çka ky studim tregon është se efektet anësore negative të ndikimit të jashtëm, ose ‘mbylljet’ siç janë cilësuar në këtë punim, mund të funksionojnë madje edhe kundër ndikimit pozitiv të së kaluarës ose angazhimit politik të të njëjtëve aktorë. Rekordi i së shkuarës së Turqisë në ndihmë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, gjatë tranzicionit të tyre të gjatë post-komunist dhe të atij të post-konfliktit, mund të konsiderohet në ditët e sotme si një zhvillim më i paqartë. Duke pasur parasysh kthesën autoritare të Turqisë, edhe asociet pozitive të së shkuarës mund të kthehen potencialisht kundër procesit të konsolidimit demokratik të Ballkanit Perëndimor dhe përpjekjeve për t’iu bashkuar Bashkimit Evropian.



## Nga brenda-jashtë: Dimensioni I – Strategjitë politike dhe aktoriteti

Diskutimi në seksionin e mëparshëm ka theksuar se për të kuptuar plotësisht mekanizmin e ndikimit të huaj negativ në Ballkanin Perëndimor, më shumë vëmendje akademike duhet t'i kushtohet shpjegimeve të "anës së kërkesës". Perspektiva e theksimit të përgjegjësive të elitave të brendshme dhe forcave politike dhe roli i tyre qendror në marrjen e vendimeve që lehtësojnë rritjen e rolit dhe të ndikimit të fuqive të huaja ka tërhequr një interes të konsiderueshëm. Në vitet e fundit, një numër në rritje analistësh kanë aspiruar të kuptojnë anën e kërkesës në mënyrë që të vlerësojnë, për shembull, levën dhe ndikimin e Kinës në mënyrë më të saktë (p.sh. Brautigam and Rithmire 2021; Jones and Hameiri 2020). Por shpjegimet e anës së kërkesës natyrisht nuk janë të reja në Ballkanin Perëndimor dhe nuk janë të izoluar në rastin e Kinës. Siç vëren Bechev, kur nënvizon rolin e aktorëve ballkanikë që ndihmojnë ndikimin e Rusisë në rajon, ka pasur gjithmonë "të asociuar dhe bashkëpunëtorë të gatshëm", "bashkëudhëtarë" ose "kancelarë politikë" të gatshëm për të bërë punën në mënyrë që të përparojnë interesat e tyre politike dhe ekonomike (Bechev 2017, 247-248).

Në këtë kapitull, në vend që të përqendrohemi thjesht tek ana e kërkesës, ne propozojmë të përqendrohemi më gjerësisht tek dinamikat që burojnë nga vendasit dhe kanë një orientim të jashtëm ose një perspektivë të ashtuquajtur "nga brenda-jashtë". Preferenca për perspektivën 'nga brenda-jashtë' është fakti se ajo thekson se analiza nuk duhet të përqendrohet vetëm tek aktorët vendas dhe politikën e tyre, por edhe në faktin se këta aktorë projektojnë vizionet, idetë dhe interesat e tyre tek agjencia e huaj ose tek perceptimi dhe ndikimi i saj. Rezultati nuk është thjesht një bashkëveprim i perspektivave dhe politikave të jashtme dhe atyre të brendshme ('nga jashtë-brenda'), por një kusht me të cilin agjencia e huaj zhvishet nga atributet e saj 'objektive' dhe gjithnjë e më shumë po portretizohet, imagjinohet, perceptohet përmes lenteve të aktorëve vendas dhe interesat, preferencat dhe agjendat e tyre konkurruese. Në këtë seksion fokusi është tek strategjitë dhe aktoriteti politik i aktorëve vendas, ndërsa seksioni tjetër do të përqendrohet tek narrativat dhe instrumentet e tyre.

Si fillim, një rast ilustrues është ndërlikimi i marrëdhënieve të maqedonasve etnikë me Perëndimin. Në studimin e tij, Naunov (2020) argumenton bindshëm se ka më shumë se sa bie në sy kur bëhet fjalë për qëndrimet e maqedonasve etnikë për orientimin gjeopolitik të vendit të tyre.

Naunov përdor një shumicë sondazhesh të opinionit publik për të treguar se orientimi pro-Perëndimor i Maqedonisë së Veriut nuk është aq i ankoruar në qëndrimet publike siç shpesh supozohet. Më konkretisht, jo vetëm që nuk diferencohet në lidhje me prejardhjen kombëtare të të anketuarve në Maqedoninë e Veriut, me shqiptarët etnikë që janë më pro-Perëndimor në orientimin e tyre, një fakt që tashmë është i njohur nga literatura. Ekziston gjithashtu një ndarje dukshëm e fortë dhe në zgjerim e sipër në mes opinionit publik etnik maqedonas midis atyre që janë qartë pro-BE-së dhe pro-NATO-s dhe atyre që nuk janë të sigurt për simpatitë e tyre dhe janë pranues të mesazheve politike anti-Perëndimore.

Naunov tregon se kjo ndarje ka të bëjë shumë me preferencat e partisë dhe rreshtimin me secilin prej të dy shtyllave kryesore të spektrit partiak maqedonas (Hislope 2013). Qëndrimet anti-Perëndimore janë shumë më të theksuara dhe gjithnjë e më popullore mes votuesve të VMRO-DPMNE-së konservatore, ndërsa votuesit e LSDM-së së qëndrës së majtë, aktualisht në pushtet, priren të lëvizin në drejtim të kundërt, duke qenë gjithnjë e më shumë pro-Perëndimor. Përkrahësit e VMRO-DPMNE-së janë shumë më skeptikë ose të ndarë për sa i përket orientimin gjeopolitik Perëndimor të vendit; ata janë jashtëzakonisht të gatshëm të shohin miratimin e kultivimit të marrëdhënieve më të forta politike me Rusinë; dhe më të gatshëm të njohin afërsinë me Rusinë kur bëhet fjalë për moralin dhe vlerat, si dhe për kulturën dhe jetën intelektuale, në krahasim me afërsitë me Perëndimin në po të njëjtat sfera.

Një tipar interesant është se për të gjitha qëndrimet e famshme anti-Perëndimore të shumë serbëve në rajon, Naunov tregon se mbështetësit e partisë konservatore maqedonase duket se i tejkalojnë homologët e tyre serbë në ndjenjat anti-Perëndimore. Siç vëren ai, "54% e mbështetësve të VMRO-DPMNE-së dhe 51% e mbështetësve të SNS-së së Vuçiçit besojnë se BE-ja po e shtyn vendin e tyre drejt largimit nga vlerat e tyre tradicionale, në vend që ti ndihmojë ata të përqafojnë një konceptim më çlirues të vlerave dhe të të drejtave. Në krahasim, 41% të mbështetësve ... [të]... partisë serbe SNSD të Milorad Dodikut [anëtar i Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës]... - një parti pro-Rusisë që përqafon nacionalizmin serb- janë po aq të kujdesshëm ndaj ndikimit të BE-së në sferën e të drejtave të njeriut" (Naunov 2020, 8). Në mënyrë të ngjashme, mbështetësit e partisë së Presidentit serb Vuçiç janë shumë më të gatshëm





të pranojnë lidhje më të forta me BE-në, në krahasim me mbështetësit e VMRO-DPMNE-së së Hristijan Mickocki-t.

Prandaj, shpjegimi i anës së kërkesës është i rëndësishëm për të kuptuar gjeopolitikën komplekse të Maqedonisë së Veriut. Analiza e Naunov-it tregon qartë për një 'oreks' të rëndësishëm për ndikim jo-Perëndimor, në këtë rast rus, por në perspektivë, dhe jo vetëm kaq, ekzistojnë dy nivele të elitave politike - këtu një nga dy shtyllat kryesore të sistemit të partisë, VMRO-DPMNE - dhe me një pjesë të dukshme të shoqërisë, e cila është e hapur ndaj një mesazhi anti-Perëndimor, qoftë i heshtur apo i qartë. Risia kryesore e Naunov-it është se ai propozon një shpjegim për këtë fenomen jo gjithmonë të dukshëm dhe një mekanizëm të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja përmes së cilit duket se funksionon. Dhe ky funksionim është i ndërlikuar sepse në mënyrë deklarative ish partia në pushtet mbetet besnike ndaj politikës së jashtme pro-Perëndimore të vendit të saj (Koneska 2014), pasi ky qëndrim sjell me vete shpërblime politike dhe ekonomike ndërkombëtare. Duke përdorur teorinë e orientimit nga partia, Naunov tregon se VMRO-DPMNE-ja "ka gjetur një mënyrë për të luajtur në të dy fushat" dhe efektivisht elitat e saj "jo vetëm që kanë injoruar vazhdimisht parimet kyçe Euro-Atlantike, por ato gjithashtu kanë sfiduar haptazi kërkesat e shprehura nga BE-ja në lidhje me korrupsionin, intolerancën etnike dhe erozionin demokratik." (Naunov 2020, 9; also Gjuzelov and Ivanovska Hadjievaska 2020) Votuesit e zakonshëm dhe mbështetësit e partisë kanë dekoduar strategjinë e dyfishtë të elitave të VMRO-DPMNE-së, duke pranuar se "angazhimi i partisë ndaj BE-së dhe NATO-s është i paqëndrueshëm dhe pothuajse vetëm pragmatik" (Naunov 2020, 9). Ndaj, mbështetësit e partisë janë përpjekur të ndjekin atë çka ata identifikojnë si ide dhe vlera të mirëfillta politike, duke hedhur poshtë orientimin pro-Perëndimor, një opsion i ndërlidhur gjithnjë e më shumë kryesisht me qendrën e majtë LSDM, dhe duke mbështetur gjithnjë e më shumë preferencat anti-Perëndimore.

Në mënyrë të ngjashme, për Vladislavjev-in (2021), Kina ishte një gur themeli i agjendës politike të zhvilluar nga elitat politike serbe në dekadën e fundit. E ashtuquajtura "miqësi e çeliktë" midis Kinës dhe Serbisë mbështetej tek komponentët ekonomikë, politikë, teknologjikë dhe të infrastrukturës, ku të gjitha ishin thelbësore për politikën në zhvillim të Presidentit Vuçiç dhe të qeverisë së tij dhe për dominimin gradual të SNS-së në panoramën politike serbe. Vladislavjev argumenton se popullariteti i Kinës midis qytetarëve serbë i ofroi mundësi të reja Vuçiçit dhe opsionit të tij politik, duke i ofruar atyre legjitimitetin për të ndjekur një

agjendë politike, e cila nuk mund të shihej si shumë kontroverse, dhe mundësisht të konsolidonte pushtetin politik si asnjë parti tjetër që nga vitet 1990. Në atë kontekst, elitat në pushtet të Serbisë përdorën faktorin Kinë për të centralizuar më tej pushtetin politik dhe për të nxitur më tej kontrollin mbi aparatit shtetëror, dhe përdorën një qasje të tillë në shtet dhe në politikë për të thelluar më tej partneritetin me Kinën (Prelec 2020a; Vladislavjev 2021).

Mënyra se si aktorët vendas implikojnë ose përdorin fuqitë e huaja në konkurrencën dhe mosmarrëveshjet e tyre politike ilustron bukur në letër gjithashtu nga Stefan Jojic (2021), i cili na çon në nivelin nën-kombëtar të Serbisë. Fuqia e huaj në fjalë është Turqia dhe aktorët e ndryshëm të brendshëm të komunitetit boshnjak në Serbi. Analizat e marrëdhënieve të Turqisë me Ballkanin Perëndimor përqendrohen zakonisht në politikën e jashtme të Turqisë në vetvete, nivelet e ndryshme në të cilat shpaloset prania turke në rajon (politiko-diplomatike, ekonomike, kulturore etj.), veprimtaria e organizatave dhe agjencive turke ose ndërveprimet dypalëshe të nivelit të lartë midis Ankarasë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Studimi i Jojic përmbys fokusin e zakonshëm të analizës për të kthyer vëmendjen tonë tek mikpritja e pranisë turke, qoftë si politika aktuale, përfshirje e mundshme ose thjesht imazh dhe reputacion i Turqisë, nga aktorët vendas, dhe më saktësisht ata të zonave të komunitetit boshnjak në rajonin e Sanxhakut në Serbi. Analiza e Jojic e bën të qartë shumëllojshmërinë e realiteteve në terren: përvojën e jetuar të të qenurit pakicë boshnjake në Serbi; realitetin e një ekonomie lokale të shembur që kurrë nuk u ringjall që nga fundi i komunizmit; konkurrencën e ashpër të partive kryesore boshnjake, SDA, SDP, SPP dhe të rrjeteve të tyre klienteliste, aksesin tek mbajtësit e pushtetit në Beograd ose pjesëmarrjen e tyre në strukturat qeverisëse; edhe kompleksitetin e Serbisë në pasjen e dy strukturave zyrtare të ndryshme dhe konfliktuale të Komunitetit Islamik, ku të dyja pretendojnë autoritetin mbi popullatat myslimane të vendit.

Kështuqë Turqia hyn në skenë, jo thjesht si një aktor i rëndësishëm rajonal që angazhohet diplomatikisht me qeverinë zyrtare në Beograd; as thjesht si një vend i huaj me të cilin kombi boshnjak tradicionalisht ka një lidhje dhe afërsi emocionale (Huskic 2020). Përkundër, Turqia negociohet nga palët e interesuara lokale si një imagjinatë politike, në bazë të përvojës së politikave të saj dhe si një aktor i mundshëm me ndikim. Prandaj, larg nga të qenurit të Turqisë një ndikim monolit i pranueshëm, këta aktorë lokalë boshnjakë



negociojnë fuqinë dhe ndikimin e Ankarasë bazuar në perceptimet, preferencat dhe interesat e tyre të ndërlukuara dhe të ndërthurura, si dhe në kontekstin e marrëdhënieve

të pushtetit dhe të konkurrencës midis aktorëve të ndryshëm lokalë.

## Nga brenda-jashtë: Dimensioni II – Narrativat dhe instrumentet

Seksioni i mëparshëm u përqëndrua tek strategjitë politike dhe agjencia e aktorëve të brendshëm, të cilët në mënyrë aktive negociojnë rolin dhe agjencinë e fuqive të huaja në përpjekje për të përfituar sa më shumë nga agjenda e tyre politike. Por, ndërsa kjo mund të shihet si përbërësi 'i vështirë' i perspektivës nga brenda-jashtë, dimensionin në dukje 'i butë' është gjithashtu vendimtar. Narrativat politike, të cilat ofrojnë kuptim dhe vizion asociativ me fuqitë e huaja, janë të lidhura pazgjidhshmërisht ngushtë me strategjitë e aktorëve vendas që shfrytëzojnë ndikimin e huaj për të çuar përpara agjendat e tyre politike. Një rast i tillë është përsëri Serbia. Prelec (2020a) ilustron se si investimet e huaja jo-Perëndimore, pak transparente, pak të vëzhguara dhe potencialisht më të dëmshme për mjedisin, kanë qenë pjesë e narrativës së 'rimëkëmbjes ekonomike' të Serbisë, të promovuar nga Aleksandar Vuçiç dhe SNS-ja e tij pas 2012. Ndërsa nevoja politike dhe mundësia për partinë në pushtet ndryshuan, kështu ndryshoi edhe narrativa e tyre rreth kujt ishte fuqia kryesore jo-Perëndimore që po vinte të shpëtonte Serbinë. Dhe në këtë drejtim, ndryshimi i narrativës dominuese ishte i lidhur ngushtë me konceptimin e politikës së jashtme serbe, e lidhur ngushtë me aktorët e fuqishëm jo-Perëndimorë.

Në mënyrë të ngjashme, dy studime nga Ognjan Denkovski (2021; 2020) janë angazhuar me po të njëjtën pyetje rreth kërkesës së brendshme për ndikim të huaj ose dimensionin nga brenda-jashtë siç e kemi vendosur në këtë punim, por që orienton fokusin e tyre më tepër tek instrumentet e disponueshme për një ndikim i tillë. Arsyeja dhe perspektiva mbeten të njëjta: projektimet nga brenda dhe jashtë të interesave dhe agjendës së brendshme. Por këtu, në vend të strategjive dhe narrativave, fokusi është tek instrumentet dhe levat që lehtësojnë përdorimin e ndikimeve të huaja për qëllime të brendshme. Duke përdorur teknika metodologjike inovative, Denkovski heton botën e çuditshme të propagandës dhe dezinformimit informatik të Maqedonisë së Veriut në mediat sociale dhe se si ato ndërlidhen me interesat dhe politikën e aktorëve të huaj (në këtë rast kryesisht Rusia) në rajon; tema është relativisht e re, por së fundmi ka filluar të tërheqë vëmendjen e mediave dhe të studiuesve të rëndësishëm (Metodieva 2019). Denkovski tregon

bindshëm se, jo-rastësisht, instrumentet dhe platformat informatike që u mobilizuan për të ndikuar në diskursin publik në momente politike të rëndësishme gjatë dy viteve të fundit, përfituan nga dy parti kryesore - nga VMRO-DPMNE-ja dhe nga e majta ekstreme 'Levica' – të cilat sulmuan ashpër vendimet që qeveria e Shkupit mori për të siguruar orientimin e saj gjeopolitik pro-Perëndimor.

Po kështu, instrumentet e propagandës informatike sfiduan idetë, vlerat dhe preferencat e politikave që i asocohen kësaj rruge të politikës pro-Perëndimore. Gjithashtu, fakti që të njëjtat platforma tentojnë të përhapin përmbajtje konspirative globale të djathtë i bën ato ndërmjetës të propagandës ruse ose përdorues kryesorë të përmbajtjes anti-Perëndimore të gjeneruar nga media të dyshimta ruse (Denkovski 2021). Denkovski evidentoi një përputhje të fortë midis përmbajtjes dhe mesazhit politik të gjeneruar përmes metodave dezinformimit informatik dhe "qëllimeve gjeo-politike të aktorëve të huaj të cilët kundërshtojnë progresin e vendit në rrugën e tij të integritimit Euro-Atlantik" (Denkovski 2021, 3).

Në të dy studimet e tij, Denkovski pranon se nuk ekzistojnë evidenca përfundimtare në analizën e tij të cilat konfirmojnë se aktorë të huaj kanë qenë të implikuar realisht në ngritjen, drejtimin ose orkestrimin e këtyre fushatave propagandistike informatike. Por ajo që konkludohet qartë nga studimet është se 'kërkesa' për ndikim anti-Perëndimor është qartësisht prezente tek aktorët dhe audiencat simpatizuese të këtij mesazhi, ashtu siç janë instrumentet për propagandë të mirë-organizuar anti-Perëndimore. Siç vëren autori, "... kushtet për akses të lehtë të aktorëve të interesuar në zhvillimin e fushatave dezinformuese në vend janë të pranishme, si për sa i përket njohurive teknike ashtu edhe për rrjetet ekzistuese të llogarive (të automatizuara) të cilat promovojnë ndjenjën anti-Perëndimore." (Denkovski 2020, 5) Aktorët e huaj që dëshirojnë gjithsesi të prishin procesin e trazuar të pranimit të Maqedonisë së Veriut në institucionet perëndimore "... duhet vetëm të shfrytëzojnë burimet tashmë të fuqishme në dispozicion, dhe disa mund t'a kenë bërë tashmë një gjë të tillë" (Denkovski 2021, 13).



## Konkluzione

Në këtë kapitull ne propozuam tre kategori që na ndihmuan në konceptimin e ndikimit të jashtëm nga një këndvështrim tjetër. Me kategorinë 'Hapjet' ne iu referuam mënyrave sipas së cilave politikat e aktorëve të jashtëm krijojnë mundësi të reja dhe ofrojnë potencialisht mundësi për rregullime dhe hierarki të reja gjeopolitike që nuk janë plotësisht në përputhje me vizionin perëndimor për rajonin, i cili ka qenë hegjemonik që prej fundi i luftërave jugosllave. Me kategorinë 'Mbylljet' ne iu referuam dështimeve dhe kufizimeve të këtyre alternativave që, si rezultat, përforcojnë vizionin politik Perëndimor rreth Ballkanit Perëndimor dhe identifikojnë pashmangshmërinë ose epërsinë e tij në krahasim me alternativat. Me kategorinë 'nga brenda-jashtë' ne iu referuam proceseve që zhvendosin vëmendjen tonë analitike nga politikat dhe ndikimet nga jashtë-brenda nga fuqitë e jashtme tek mënyra se si aktorët e brendshëm perceptojnë këto ndikime dhe i integrojnë ato në agjendat e tyre politike, dhe se si nga ana tjetër ata i ripaketojnë dhe i ridrejtojnë ato drejt audiencave 'të jashtme', qofshin ato vendase apo ndërkombëtare, në mënyrë që të arrijnë objektivat e tyre. Për kategorinë e tretë ne identifikuam dy nën-kategori: agjendat politike dhe aktoriteti, dhe narrativat dhe instrumentet.

Për kategorinë e 'Hapjeve', ne identifikuam mundësitë që u ofroheshin aktorëve jo-Perëndimorë nga pandemia COVID-19 për të rritur gjurmën e tyre dhe për të kapitalizuar dështimet e politikave të BE-së në përgjigje të pandemisë. Ne gjithashtu përfshimë në këtë kategori diskutimin në lidhje me ndikimin ideor të Kinës në Ballkanin Perëndimor. Nën kategorinë 'Mbylljet' ne përfshimë pasojat negative të prezantimit të qeverisë serbe të teknologjisë kineze në kontekstin e projektit 'Qytet i Sigurt' dhe gjithashtu efektet mjedisore të investimeve kineze në industrinë e rëndë të Serbisë. Ne gjithashtu përfshimë në këtë kategori vendosjen dhe konsolidimin e marrëdhënieve personale midis udhëheqësve të Turqisë nga njëra anë dhe Shqipërisë dhe Kosovës nga ana tjetër, të cilat kanë sjellë me vete një ndikim negativ për institucionet demokratike të këtyre dy vendeve të fundit.

Më pas, nën kategorinë 'nga brenda-jashtë', dhe më specifikisht nën-kategoria e strategjive politike dhe aktoriteti, ne përfshimë orientimet e liderit të zyrtarëve të VMRO-DPMNE-së në Maqedoninë e Veriut, të cilët lundronin midis mbështetjes zyrtare për orientimin pro-Perëndimor të politikës së jashtme të vendit dhe miratimit indirekt të politikave dhe vlerave që janë në kundërshtim me partnerët perëndimorë, por që flasin më shumë për zemrën e bazës së partisë së tyre dhe votuesve. Ne gjithashtu përfshomë në

këtë nën-kategori përdorimet e 'miqësisë së çeliktë' të liderit serb me Kinën dhe mënyrat e ndërlikuara ku imazhi dhe ndikimi i Turqisë përdoret dhe përshtatet nga aktorët politikë dhe fetarë boshnjakë në rajonin e Sanxhakut të Serbisë, në përputhje me agjenda të ndryshme dhe në shërbim të konkurrencës së tyre locale për pushtet dhe ndikim. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ne diskutuam nën-kategorinë e narrativave dhe instrumenteve, dhe përfshimë në të narrativën e qeverisë serbe për rimëkëmbjen ekonomike me ndihmën e fuqive jo-Perëndimore, por edhe mundësitë e shumëfishta që instrumentet e propagandës informatike në Maqedoninë e Veriut ofrojnë për ndikimi i huaj jo-Perëndimor.

Çka u bë e qartë nga analizat e ndryshme në këtë vëllim është se situata në Ballkanin Perëndimor është larg nga pikëpamja e thjeshtë e ndikimeve të huaja 'malinje kundrejt beninjë'. Pikëpamja e thjeshtëzuar mund të jetë e përshtatshme për politikëbërësit e caktuar perëndimorë në përpjekjet e tyre për të gjeneruar mbështetje popullore në Ballkanin Perëndimor dhe për të kërkuar harmonizim të politikave nga qeveritë e rajonit. Por nuk është i përshtatshëm për analiza dhe për të kuptuarit të realitetin kompleks të ndikimeve dhe agjendave në rajon. Për një gjë, jo çdo politikë perëndimore është e dobishme për rajonin, ndërsa fuqitë jo-Perëndimore sjellin u disa avantazhe vendeve që vendosin të angazhohen me ta. Duke thënë këtë, është gjithashtu një keqinterpretim i realitetit të argumentosh se 'gjithçka përparon' në rajon dhe se politikat dhe synimet e aktorëve jo-Perëndimorë janë po aq të mira apo aq të këqija sa ato të BE-së ose SHBA-së. Ka sigurisht meritë për qëllimet e mira të aktorëve perëndimorë, veçanërisht BE-ja, e cila ka investuar shuma të konsiderueshme financiare dhe kapital politik në demokratizimin dhe zhvillimin e Ballkanit Perëndimor dhe ka ofruar një vizion gjithëpërfshirës për të gjithë rajonin.

Siç vëren Srećko Latal në studimin e tij, BE-ja mbetet si "aktori i vetëm që nuk duket se ka agjendën e vet vetshërbyese në Ballkan" po ashtu edhe "lojtari i vetëm me kapacitetin për të stabilizuar dhe normalizuar rajonin në planin afatgjatë" (2020a, 17). Por për shkak të kësaj, dikush mbetet duke menduar pse ndikimi politik i BE-së nuk arrin të përputhet me kontributin e saj ekonomik në rajon dhe gjithashtu pse disa popuj në Ballkanin Perëndimor madje e nënvlerësojnë këtë kontribut ekonomik. Pjesë e historisë është publiciteti i keq dhe 'fjalët e liga' që BE-ja merr nga liderët 'aspak miqësorë' në rajon. Por, siç kanë treguar kontributet në këtë vëllim, BE-ja është gjithashtu përgjegjëse për dështimin e vazhdueshëm të angazhimit në kohë dhe në mënyrë efektive në përgjigje



të problemeve të rajonit ose për bërjen e një pune të dobët duke përfutur plotësisht nga pozita e saj superior në lidhje me lojtarët e tjerë të huaj (Latal 2020a; 2020b; 2021; Vangeli 2021). Mandej, siç tregon rasti i ndërlikimeve të fundit që kanë bllokuar procesin e pranimit të Shkupit në BE, politika e BE-së mund të mbetet viktimë e interesave kombëtare të vendeve të saj anëtare dhe të fuqisë së tyre bllokuese. Kjo atëherë mund të ketë efekte shumë të dëmshme për rolin e BE-së në rajon. Naunov në studimin e tij paralajmëron se BE-ja nuk duhet të marrë si të mirëqena shtetet mike si Maqedonia e Veriut: "... duke i kërkuar Maqedonisë së Veriut një kontroll sërish dhe përsëri, mund të rrezikojë në mënyrë të pariparueshme besimin e qytetarëve të Maqedonisë tek BE-ja dhe në besueshmërinë e angazhimit të BE-së ndaj vendit ... [çka] është tashmë më e pasigurt sesa supozohet shpesh" (Naunov 2020, 12).

Një tjetër përfundim nga studimet në këtë vëllim është se ideja që aktorët e brendshëm janë thjesht marrësit e dobët të

ndikimeve të jashtme nuk mund të jetë më largë së vërtetës. Diskutimi i anës së kërkesës ose perspektivat nga Brenda-jashtë në kapitullin tonë ka treguar se elitat e brendshme dhe strategjitë e tyre janë faktorë thelbësorë që mundësojnë mjedisin për ndikim të huaj. Pavarësisht synimeve të vërteta të vendeve si Kina, Rusia, Turqia apo të tjerët, skena është paracaktuar tashmë dhe mundësitë për ndikim të huaj ekzistojnë. Të dyja elitat dhe shoqëritë që nuk gjejnë më ngushëllim ose nuk janë të bindura nga domosdoshmëria apo pashmangshmëria e objektivit makro-politik të integritetit në Perëndim mund të jenë simpatizuese për ndikim të aktorëve jo-Perëndimorë. Gjithashtu, siç u bë e dukshme në vëllimin tonë, forcat e brendshme politike nuk janë as marrës të pranueshëm të një ndikimi të tillë, por përkundrazi ato formëzojnë në mënyrë aktive imazhin dhe mesazhin e aktorëve të huaj në funksion të vënies së tyre në shërbim të agjendës dhe interesave të tyre më të gjera politike.

## Referencat

Bartlett, Will and Tena Prelec. 2020. "UAE – Sultanism meets illiberal democracy." In *The Western Balkans in the World: Linkages and Relations with Non-Western Countries*, edited by Florian Bieber and Nikolaos Tzifakis, 241-259. Southeast European Studies: Routledge.

Bartlett, Will, Ker-Lindsay, James, Alexander, Kristian and Prelec, Tena. 2017. "The United Arab Emirates as an emerging actor in the Western Balkans: The case of strategic investment in Serbia." *Journal of Arabian Studies* 7 no.1: 94 -112.

Bechev, Dimitar. 2017. *Rival Power: Russia in Southeast Europe*. Yale University Press.

Bishku, Michael B. 2016. "Bosnia and the Middle East: Current Political, Economic and Cultural Ties." *Journal of Muslim Minority Affairs* 36 no. 2: 202 – 218.

Bjeloš, Maja. 2020. "The Sum of All Fears – Chinese AI Surveillance in Serbia. 2020." Prague: Prague Security Studies Institute.

Bjeloš, Maja, Sterić, Luka and Vuksanović, Vuk. 2020. "Many Faces of Serbian Foreign Policy Public Opinion and Geopolitical Balancing." Belgrade Centre for Security Policy, November 11, 2020. <https://bezbednost.org/en/publication/%0Dmany-faces-of-serbian-foreign-policy-public-opinion-and-%0Dgeopolitical-balancing/>.

Bieber, Florian. 2020. *The Rise of Authoritarianism in the Western Balkans*. Palgrave Pivot.

Bieber, Florian and Nikolaos Tzifakis. Eds. 2020. *The Western Balkans in the World: Linkages and Relations with Non-Western Countries*. Routledge.

Brautigam, Deborah and Meg Rithmire. 2021. "The Chinese 'Debt Trap' Is a Myth." *The Atlantic*, February 6, 2021. <https://www.theatlantic.com/international/archive/2021/02/china-debt-trap-diplomacy/617953/>.

Todorović Štiplija, Nemanja, eds. 2021. "Serbian Media Reporting on the European Union 2020 "Love from China and Slaps from Brussels"" Belgrade: CSP and European Western Balkans.

Tsimonis, Konstantinos, et al. 2020. "A Synergy of Failures: Environmental Protection and Chinese Capital in Southeast Europe." *Journal of Chinese Affairs* 00(0) 1- 30. May, <https://doi.org/10.1177/1868102620919861>.

Daily Sabah. 2021. "Turkish hospital opens in Albania, a symbol of friendship". Daily Sabah, April 21, 2021 <https://www.dailysabah.com/turkey/turkish-hospital-opens-in-albania-a-symbol-of-friendship/news>

Denkovski, Ognjan. 2020. Infodemics, a snap election and a (lukewarm) Western welcome: North Macedonia's identity at stake on Twitter. Study I – Instruments of Disinformation. Prague: Prague Security Studies Institute.

Denkovski, Ognjan. 2020. Infodemics, a snap election and a (lukewarm) Western welcome: North Macedonia's identity at stake on Twitter. Study II – Content of Disinformation. Prague: Prague Security Studies Institute.

Dzankić, Jelena, Soeren Keil and Kmezić, Marko. 2019. *The Europeanisation of the Western Balkans: A Failure of EU Conditionality?* Palgrave Macmillan UK.

Ejduš, Flip. 2017. "The impact of Turkey and the Gulf States". In *Resilience in the Western Balkans*, edited by Sabrina Lange, Yoran Nechev and Florian Trauner.. Luxembourg: Institute for Security Studies.



- European Commission Staff Working Document. 2020. "Serbia 2020 Report." Brussels: European Commission. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia_report_2020.pdf)
- Grabbe, Heather. 2006. *The EU's Transformative Power: Europeanization Through Conditionality in Central and Eastern Europe*. Palgrave Macmillan UK.
- Gjuzelov, Borjan and Milka Ivanovska Hadjievska. 2019. "Institutional and symbolic aspects of illiberal politics: the case of North Macedonia (2006–2017)." *Southeast European and Black Sea Studies* 20, no. 1: 41 – 60.
- Hameiri, Shahar and Lee Jones. 2020. "Debunking the Myth of 'Debt-trap Diplomacy': How Recipient Countries Shape China's Belt and Road Initiative." Chatham House. <https://www.chathamhouse.org/2020/08/debunking-myth-debt-trap-diplomacy/references>
- Hislope, Robert. 2013. "Macedonia." In *The Handbook of Political Change in Eastern Europe*, edited by Sten Berglund et al. Third Edition. Edward Elgar Publishing.
- Hopkins, Valerie. "Bounty of Serbian vaccine diplomacy shames the EU." *Financial Times*. <https://www.ft.com/content/81fc28aa-04a9-4108-a69b-80dc93a9e985>
- Huskić, Adnan. 2020. "Kosovo: Between Western and Non-Western States." In *The Western Balkans in the World: Linkages and Relations with Non-Western Countries*, edited by Florian Bieber and Nikolaos Tzifakis, 83-107. *Southeast European Studies*: Routledge.
- Jojić, Stefan. "Erdogan as an admired sultan or an instrument in political competition?: Locals' perceptions of the Turkish presence in Serbian Sandžak." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Koneska, Cvete. "Policy Consensus During Institutional Change: Macedonian Foreign Policy Since Independence." In *The Foreign Policies of Post-Yugoslav States: From Yugoslavia to Europe*, edited by Soeren Keil and B. Stahl. *New Perspectives on South – East Europe*: Palgrave Macmillan UK.
- Koppa, Maria Eleni. 2020. "Turkey, Gulf States and Iran in Western Balkans: more than the Islamic factor?" *Journal of Contemporary European Studies*. April 2020.
- Latal, Srećko. 2020a. "COVID-19 Raises Geopolitical Stakes in the Balkans." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Latal, Srećko. 2020b. "The Western Balkans: Between the EU and a Hard Place." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Latal, Srećko. 2021. "BiH's Decisive Electoral reform Strikes New Divisions among Internal and External Actors." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Lilyanova, Velina. 2017. "Saudi Arabia in the Western Balkans" in 'At a glance', European Parliament. November, 2017.
- Madhi, Gentiola. 2021. "'Our brother' Erdogan – From official to personal relations of political leaders of Albania and Kosovo with the Turkish President." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Mandaci, Nazif. 2017. "Western Balkans and the Gulf: Interregionalism in the making." *Mediterranean Politics* 23, No.3: 340 – 363.
- Metodieva, Asya. 2019. "Russian Narrative Proxies in the Western Balkans." *The German Marshall Fund of the United States*. <https://www.gmfus.org/sites/default/files/publications/pdf/Russian%20Narrative%20Proxies%20in%20Balkans.pdf>.
- Naunov, Martin. 2020. "Is the EU Taking Friends for Granted? Partisanship and Support for External Actors in North Macedonia." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Oktem, Kerem and Karabekir Akkoyunlu, eds. 2018. *Exit from Democracy: Illiberal Governance in Turkey and Beyond*. Routledge.
- Ozturk, Ahmet Erdi. 2021. *Religion, Identity and Power: Turkey and the Balkans in the Twenty-First Century*. Edinburgh University Press.
- Pavlović, Dušan. 2019. "The political economy behind the gradual demise of democratic institutions in Serbia." *Southeast European and Black Sea Studies* 20, no. 1: 19 – 39.
- Prelec, Tena. 2020a. "'Our brothers', 'our saviors': The importance of Chinese investment for the Serbian government's narrative of economic rebound." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Prelec, Tena. 2020b. "The Vicious Circle of Corrosive Capital, Authoritarian Tendencies and State Capture in the Western Balkans." *Journal of Regional Security* 15, no. 2: 167 – 198. May 2020.
- Prelec, Tena. 2021. "Eco- monsters and eco- fighters: China's investments in Serbia's heavy manufacturing industry as seen through an environmental lens." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Pyatt, Geoffrey. 2021. "Ambassador Pyatt's Remarks at the George C. Marshall Center's Virtual Seminar on Countering Malign Influence." Official website of the US Embassy in Greece, Tuesday, March 2, 2021, <https://gr.usembassy.gov/ambassador-pyatts-remarks-at-the-george-c-marshall-centers-virtual-seminar-on-countering-malign-influence/>.
- Reuters. 2021. "Albania gets 192,000 doses of Chinese Sinovac vaccine." Reuters, March 25, 2021. <https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-albania-vaccines-idUSKBN2BH2N9>
- Simic, Julija. 2020. "Serbia turns to China due to 'lack of EU solidarity' on coronavirus." *Euractiv*, 18 March, 2020. <https://www.euractiv.com/section/china/news/serbia-turns-to-china-due-to-lack-of-eu-solidarity-on-coronavirus/>
- Vachudova, Milada Anna. 2005. *Europe undivided: democracy, leverage, and integration after communism*. Oxford University Press.
- Vangeli, Anastas. 2020. "Western Balkan Discourses on and Positioning Towards China During the COVID–19 Pandemic." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Vangeli, Anastas. 2021. "China's Ideational Impact in the Western Balkans 2009– 2019." Prague: Prague Security Studies Institute.
- Vladislavljev, Stefan. 2021. "'Steel Friendship'- Forging of the Perception of China by the Serbian Political Elite." Prague: Prague Security Studies Institute.

